

VETERANI

GAZETË PERIODIKE NR. 2 (326) Shkurt 2016 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

PËRVJETORI

Rruga e Kosovës drejt Pavarësisë

Sfida më e afërt për shtetin e ri është heqja e vizave, por kryesorja mbetet aspirata për hyrjen në NATO dhe integrimin në BE. Zyrtarisht, deri më sot,...



FAQË 3

KUVENDI

Çamëria plotëson hartën e kombit shqiptar

Dr. Abaz Hado, kreu i ri i Shoqatës Patriotike "Çamëria" ka drejtuar me sukses institucione të rëndësishme në vend, si Galerinë e Arteve etj. Hado ka shërbyer si zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...



Nga Halil RAMA FAQË 3

DEBAT

Kush e bëri luftën: politikanët, familjet e mëdha apo ushtarakët e devotshëm? FAQË 2



USHTARAKËT JANË ELITA E KOMBIT

Nga Sakip CAMI

Ftesa për ta rishkruar historinë qëndron në rend të ditës për vetë faktin se në 45 vjet të pasluftës komunistët morën vetëm meritat e kësaj lufte të lavdishme dhe hodhën balte mbi aleatët e tyre të brendshëm dhe të jashtëm.

Në këto 25 vite demokraci nuk është bërë pothuajse asgjë për ta rishkruar drejt historinë tonë sepse partitë politike që kanë ardhur herë pas here në pushtet kanë dashur që ta rishkruajnë historinë sipas pikpamjeve dhe interesave të tyre. Thënë më troë pasuesit dhe bijtë e komunistëve dhe partizanëve mbrojnë tezën se luftën e bënë baballarët e tyre, ndërsa pasuesit dhe bijtë e legalistëve dhe ballistëve dhe në një rradhë me to, të djathtët shqiptarë, janë gati të nxinë gjithçka, edhe gjakun e kuq të derdhur, mjafton që kjo meritë të mos jetë e komunistëve shqiptarë.

Dhe në këtë debat shterpë ku kanë marrë pjesë politikanët në rradhë të parë, gazetarët në rradhë të dytë, njerëzit pa ingritet në rradhë të tretë dhe aspak historianët, deri më tani nuk ka dalë asgjë në dritë sepse historianët janë rreshtuar në parti politike dhe kanë mbështetur tezat politike të partive ku militojnë.

(Vijon në faqen 2)

Ministria Kodheli flet për aksionet që po ndërmer Ministria e Mbrojtjes në aspektin e modernizimit të FA

Shqipëria është një vend i sigurt



Ministria Kodheli: "Shqipëria është një vend i sigurt, por kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht është një vend imun ndaj fenomenit të terrorizmit"

IN MEMORIAM

Mustafa Gjinishi - një Hero i harruar

Nga Shpendi TOPOLLAJ



FAQË 6-7

PROFIL

Fatime Kërçuku – kariera universitare e gruas ambicioze

Gruaja nga Durrësi, simbol i mençurisë dhe identitetit njerëzor në Italinë fqinje



FAQË 12

DOSSIER

Maliq Topuzi, dhëndërr i dasmës së lirisë

Nga Shaqir Çerçja

FAQË 10

Zadrime (Tejdrina) e vetëqeverisur për më se dy shekuj

Nga Xhemal Meci



FAQË 11

DEBAT

KUSH E BËRI LUFTËN: POLITIKANËT, FAMILJET E MËDHA APO USHTARAKËT E DEVOTSHËM?

ROLI I USHTARAKËVE TË MIRËFILLTË GJATË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE



Ftesa për ta rishkruar historinë qëndron në rend të ditës për vetë faktin se në 45 vjet të pasluftës komunistët morën vetëm meritat e kësaj lufte të lavdishme dhe hodhën baltë mbi aleatët e tyre të brendshëm dhe të jashtëm.

Në këto 25 vite demokraci nuk është bërë dotuajse asgjë për ta rishkruar drejt historinë tonë sepse partitë politike që kanë ardhur herë pas here në pushtet kanë dashur që ta rishkruajnë historinë sipas pikpamjeve dhe interesave të tyre. Thënë më troë pasuesit dhe bijtë e komunistëve dhe partizanëve mbrojnë tezën se luftën e bënë baballarët e tyre, ndër-sa pasuesit dhe bijtë e legalistëve dhe ballistëve dhe në një rradhë me to, të djathtët shqiptarë, janë gati të nxinin gjithçka, edhe gjakun e kuq të derdhur, mjafton që kjo meritë të mos jetë e komunistëve shqiptarë.

Dhe në këtë debat shterpë ku kanë marrë pjesë politikanët në rradhë të parë, gazetarët në rradhë të dytë, njerëzit pa ingritur në rradhë të tretë dhe aspak historianët, deri më tani nuk ka dalë asgjë në dritë sepse historianët janë rreshtuar në parti politike dhe kanë mbështetur tezat politike të partive ku militojnë.

Është për të ardhur keq, por Akademia e Shkencave dhe Instituti i Historisë nuk thonë dot akoma se në çfarë date është çliruar Shqipëria dhe për të mos hyrë në debat me politikanët propozojnë ditën e çlirimit të kryeqytetit. Ndërkaq vetë gjermanët duke ju referuar arkivave të luftës pranojnë se janë larguar nga qyteti verior i Shqipërisë më 29 nëntor 1944.

Është për të ardhur keq, por një libër i shkruar nga një gazetar për Ahmet Zogun vlerësohet më shumë se libri i një historiani të shquar. Njerëz mediokër vlerësojnë më shumë fotografi dhe episode se sa fakte dhe të dhëna historike.



Jo pa qëllim nuk festohet 10 korriku i vitit 1943, që të mos thuhet se komandant i Shtabit të Përgjithshëm ka qenë Spiro Moisiu, një ushtarak karriere me tre akademi ushtarake. Festohet 17 nëntori i vitit 1944 si ditë e çlirimit të kryeqytetit shqiptar, Tiranës, por askush nuk e thotë se planin për çlirimin e Tiranës e hartoi komandanti i Korp armatës së I-rë dhe Zv/komandant i Shtabit të Përgjithshëm Dali Ndreu, një ushtarak karriere, kuadër ushtarak artilerie i përgatitur në Akademinë Ushtarake të kohës së Zogut, akademi nën mbikqyrjen e ushtakëve italianë.

Kjo është pjesë e tablos së sotme të këndvështrimit të historisë nga shoqëria jonë. Tablo arrin deri aty sa lufta fragmentohet në familje, fise e emra të përveçëm që dikur dhe kurrë asnjëherë nuk kanë patur rol në këtë luftë, por njerëz me para, pushtet dhe me dije të mbrapshta dinë mirë të bëjnë një gjë, shtrembërimin e historisë.

Dhe ndodh që në sheshe qytetesh të vendosen figurat të dyshimta historike dhe akoma më keq figura që kanë llyer duart me gjakun e shqiptarëve.

Nën mburojën e luftës kundër komunistëve, të ashtuquajturit antikomunistë, por asnjëherë të vetme nacionalistë, të apasionuar pas karrikes së pushtetit dhe parasë së pamerituar kanë arritur që tu puthin dorë pushtuesve dhe të marrin detyra e ofiqe shtetërore të pamerituara.

A mund të quhen pushtetarë proshqiptarë ata që lejuan dhe organizuan masakrën e 4 shkurtit të vitit 1944 në Tiranë? A duhet tu ngrihen buste njerëzve të tillë

që vranë popullin e vet? Po atyre që organizuan tërë Veriun për të nënshtruar Jugun dhe Vlorën që po rezistonte ndaj pushtuesve italianë në vitin 1942? A duhet t'u bëhen libra e monografi, dokumentarë dhe filma, figurave të tilla të dyshimta vetëm e vetëm sepse bijtë dhe nipërit e tyre kanë para dhe pushtet?

A po ecim në rrugën e gabuar kështu, duke shtrembëruar historinë dhe duke u futur njerëzve në tru shiringën e veprimit antikombëtar.

Disa arrijnë deri aty sa thonë se do të ishte mirë të mos ishim çliruar, të kishim ndenjtur nën Itali apo Gjermani. Mediokriteti arrin deri aty sa që duke mos njohur ligjet e luftës dhe të paqes pasluftës nuk e dinë se duke u rreshtuar me humbësit e një lufte automatikisht ke humbur gjithçka, integritetin territorial, pasurinë kombëtare, dinjitetin kombëtar etj.

Në vijim të këtij debati dëshiroj të nënvizoj edhe një fakt tjetër shumë domethënës që është shtrembëruar me qëllim të caktuar. Është mo-

huar roli i ushtarakëve të përgatitur dhe të shkolluar gjatë luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Ata erdhën nga akademitë ushtarake të Italisë dhe të Austrisë ku studionin, për ti dalë zot Shqipërisë, për ta çliruar vendin e tyre dhe askush deri më sot nuk e ka evidentuar rolin e tyre vendimtar në këtë luftë.

Po të intervistosh brezin e ri, me keqardhje, por duhet pranuar se nuk e dinë se kur është çliruar Shqipëria, se kur është shpallur pavarësia, se kush ka qenë komandant i Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare etj.

Jo pa qëllim nuk festohet 10 korriku i vitit 1943, që të mos thuhet se komandant i Shtabit të Përgjithshëm ka qenë Spiro Moisiu, një ushtarak karriere me tre akademi ushtarake.

Festohet 17 nëntori i vitit 1944 si ditë e çlirimit të kryeqytetit shqiptar, Tiranës, por askush nuk e thotë se planin për çlirimin e Tiranës e hartoi komandanti i Korp armatës së I-rë dhe Zv/komandant i Shtabit të Përgjithshëm

Dali Ndreu, një ushtarak karriere, kuadër ushtarak artilerie i përgatitur në Akademinë Ushtarake të kohës së Zogut, akademi nën mbikqyrjen e ushtakëve italianë. Po kështu Tahir Kadare, Zv/Komandant i Brigadës I-rë Sulmuese, komandant i Brigadës së VI, Komandant i Divizionit të II, Komandant i Korp Armatës II, deri në Zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm ishte një ushtarak karriere i përgatitur në shkollën ushtarake shqiptare.

Ushtarakët që drejtuan faktikisht operacionin e dimrit 1943/1944 dhe operacionin e qershorit 1944 si dhe betejet më të rëndësishme të luftës si lufta 20 ditore për çlirimin e Tiranës, etj ishin ushtarakë të mirëfilltë të përgatitur dhe patriotë deri në flijim për çeshtjen kombëtare. Ata janë të shumtë. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe sepse luftën ku varej fati i mjërave shqiptarëve nuk mund ta drejtonin çobenët pa njohuri ushtarake, qofshin këta patriotë më të mëdhenj që mund të egzistojnë.

Këtë ushtarakë erdhën nga Italia pasi braktisën akademitë ushtarake dhe u rreshtuan në frontin e luftës duke marrë detyrat dhe përgjegjësitë, gradat ushtarake hap pas hapi, ushtarakë të tillë, që më vonë do të persekutoheshin nga regjimi komunist si Hamit Keçi, Skender Malindi, Todi Naço, Kadri Hoxha etj.

Unë, nuk do të mohoj kurrë rolin e familjeve të mëdha shqiptare patriotë që vunë gjithçka në funksion të luftës, por ky rol do të minimizohej deri në zhdukje pa pjesëmarrjen dhe rolin e ushtarakëve drejtues.

Unë nuk do të mohoj kurrë edhe rolin e politikanëve dhe partive politike shqiptare gjatë luftës, por kurrë nuk do të pranoja mohimin që u bënë ata ushtarakëve që drejtuan konkretisht operacionin luftarak, mohim që shkoi deri në burgosjen dhe zhdukjen fizike të tyre.

Drejt ushtarakëve të mos vështrojmë vetëm kur kemi nevojë për ta, për luftën kundër terrorizmit, për mënjanimin e përmblytjeve dhe fatkeqësive natyrore etj, por të kemi një vështrim të njëlojtë me vendet e NATO-s ku militon vendi ynë.

Ushtarakët janë elita e kombit.

Sakip Cami
Ish ushtarak, publicist

SPECIALE

Kurorëzimi i një rrugëtimi të dhimbshëm lotësh e gjaku për popullsinë shqiptare

Rruga e Kosovës drejt Pavarësisë

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, ishte kurorëzimi i një rrugëtimi të dhimbshëm lotësh e gjaku për popullsinë shqiptare atje. Për vite me radhë, deri në qershor të 1999-ës, shqiptarët vuajtën pasojat e spastrimit etnik nga ushtria e Millosheviçit. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së trupave ndërkombëtare në Kosovë, në nëntor 2005 nisi zyrtarisht procesi për statusin përfundimtar.

Prej 13 qershorit të vitit 1999, kur forcat serbe u detyruan të largoheshin nga Kosova, ky vend administrohej nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK dhe institucionet demokratike të Kosovës: Kuvendi, Presidenti dhe qeveria. Edhe pse Serbia nuk kishte kontroll mbi Kosovën, në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, disa herë përmendej se Kosova është protektorat i OKB-së, por juridikisht pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Më 2 shkurt 2007 i dërguari special për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij në



Prishtinë dhe Beograd, për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, hap që çoi drejt krijimit të shtetit të pavarur. Pasi u mbajtën disa raunde bisedimesh, Kosova u shpall e pavarur më 17 shkurt 2008.

Zyra Civile Ndërkombëtare mori përsipër mbikëqyrjen e zbatimit të pavarësisë. Pak ditë më vonë, një grup vendesh që njohën pavarësinë e saj themeluan Grupin Drejtues që do të mbikëqyrte

shtetin e ri. Plani i Ahtisaarit nuk u zbatua kurrë në veriun e banuar me shumicë serbe, ku nuk njihen dhe nuk pranohen institucionet e shtetit të Kosovës. Plani parashikonte krijimin e një komune të re në veriun e Mitrovicës, që nuk është zbatuar deri më tani. Më 9 dhjetor 2008, vendin e UNMIK e zuri misioni evropian për sundimin e ligjit EULEX. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Përmbyllja e pavarësisë së mbikëqyrrur më 10 shtator 2012, shihet si një mundësi për shtyrjen më tej të hapave për integrimin e Kosovës. Sfida më e afërt për shtetin e ri është heqja e vizave, por kryesorja mbetet aspirata për hyrjen në NATO dhe integrimin në BE. Zyrtarisht, deri më sot, Kosovën e kanë njohur 111 shtete

konfirmoi përmes mendimit këshillëdhënës se pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar. Nga marsi i vitit 2011, Prishtina dhe Beogradi kanë nisur bisedimet në Bruksel për një seri çështjesh. Këto bisedime teknike u pasuan nga ato në nivel kryeministrash, me mbajtjen e katër raundeve të dialogut mes Thaçit e Daçit, si dhe një takimi mes presidentëve Jahjaga e Nikoliç.

Përmbyllja e pavarësisë së mbikëqyrrur më 10 shtator 2012, shihet si një mundësi për shtyrjen më tej të hapave për integrimin e Kosovës. Sfida më e afërt për shtetin

e ri është heqja e vizave, por kryesorja mbetet aspirata për hyrjen në NATO dhe integrimin në BE. Zyrtarisht, deri më sot, Kosovën e kanë njohur 111 shtete.

Deri tani 110 entitete sovraane, nga të cilët 111 nga 193 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës. Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian gjithashtu e kanë njohur Kosovën (23 nga 28); Anëtarët e BE-së vendosin individualisht se a do ta njohin Kosovën. Njëzetekatër (24) anëtarë të NATOs nga njëzetetatë (28) gjithsej e kanë njohur Kosovën.

Idrizi vlerëson përpjekjet e shoqatës "Çamëria" për të çuar përpara zgjidhjen e çështjes çame

Çamëria plotëson hartën e kombit shqiptar

Nga Halil RAMA

Shoqata Patriotike Çamëria zhvilloi Kuvendin e dhjetë Kombeve, gjatë të cilit u zgjodh edhe kryetari i ri i shoqatës, Dr. Abaz Hado. Në Kuvend morën pjesë delegatë nga të 19-ta degët e shoqatës. Në Kuvend merrnin pjesë nënkryetari i Kuvendit të Shqipërisë, njëherazi kryetar i PDIU-së, z. Shpëtim Idrizi, deputetët Aqif Rakipi, Omer Mamo dhe Mesila Doda, kryetarët e shoqatave "Labëria" dhe "Tirana", kryetarët e bashkive të Rrogzhanisë, Peqinit e Konispolit e një sërë personalitetesh të tjera.

Aktiviteti u çel nga kryetari pararendës i shoqatës, Dr. Ardian Tana, i cili ka drejtuar shoqatën Çamëria për 10 vite. Ai theksoi vlerën historike dhe aktivitetin e shumëanshëm të shoqatës përgjatë 25 viteve të ekzistencës së saj dhe bëri thirrje për bashkëpunim më të fortë, në mënyrë që çështja çame të gjejë zgjidhje sa më shpejtë.

"Në këtë realitet të ri është e rëndësishme që shoqata patriotike "Çamëria" të mundohet të orientojë sa më mirë përpjekjet e saj në të ardhmen, në

funksion të realizimit të kërkesave të programit. Ajo duhet të shërbejë edhe si shtrati ku gërshetohen të gjitha kontributet për zgjidhjen e çështjes çame. Përpjekjet e koordinuara garantojnë sukses. Suksesin ynë është i arritshëm dhe do të na mundësojë kthimin në trojet e të parëve tanë dhe rifitim të plotë të të drejtave të mohuara padrejtësisht." – tha z. Tana.

Kryetari i PDIU-së, z. Shpëtim Idrizi theksoi se Çamëria plotëson hartën e kombit shqiptar, duke vlerësuar përpjekjet e shoqatës Çamëria për të çuar përpara zgjidhjen e çështjes çame, prej ditëve të para të lejimit të pluralizmit në vend.

"Unë e di shumë mirë se ky rrugëtim nuk ka qenë i lehtë. Sot kemi grup parlamentar, kemi media, kemi hapësira, por unë e di sesa e vështirë ka qenë në vitet e para të gjeje një shkrim për Çamërinë. Ndaj unë vlerësoj sot burra dhe gra që për 25 vjet kanë përcaktuar e kanë mbajtur gjallë rrugën e çështjes çame. Nder e lavdi atyre që kanë punuar për 25 vjet çështjen çame. Çështja çame zgjidhet vetëm me rrugë politike duke angazhuar par-



lamentin, se nuk është çështje juridike por është politike. Se ka filluar si politikë e qartë e shtetit grek, për ta asimiluar, për ta shpërngulur, që sot mbush 103 vjet duke nisur nga viti 1913. Një politikë e qartë e cila ka kërkuar dhe ka pasur momentet e veta shumë të dhimbshme, duke filluar nga masakra e parë ku u vranë krerët e Çamërisë, me shpërnguljen e deri duke arritur me momentin me kulmor, më tragjik nga ana njerëzore, për masakrën në 1944 ku përfundimisht politika greke me strategji të qartë deportoi 90% të popullsisë duke vrarë 20% e duke sekuestruar tërë pronat. Ndaj çështja çame është politike e zgjidhet me rrugë diplomatike. Sot çështja çame flitet më shumë se kurrë në parlament, kemi një rezolutë dhe nuk do të reshimit së luftuari për të" – tha z. Idrizi.

Në këtë Kuvend u bënë dis-

Dr. Abaz Hado, kreu i ri i Shoqatës Patriotike "Çamëria" ka drejtuar me sukses institucione të rëndësishme në vend pas vitit 1990, si Galerinë e Arteve etj. Hado ka shërbyer si zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitet 2011-2013

kutime ku Hyqmet Zane, njëri nga pjesëmarrësit në krijimin e Shoqatës "Çamëria" që më 10 janar 1991 shprehu idenë se çështja çame kërkon edhe mbështetje qeveritare dhe akademike dhe nuk mund të konceptohet zgjidhja e saj pa një bashkim të aktorëve të interesuar dhe pa mbështetjen e ndërkombëtarëve.

Po kështu diskutuan edhe përfaqësues të tjerë të shoqatave në rrethe ku u hodh idea e një epërfaqësimi më të gjerë të të rinjëve.

Pas fjalëve përshëndetëse, vijoi procedura e zgjedhjes së kryetarit të ri, sipas përcaktimeve të statutit të Shoqatës Çamëria. Kandidatë në garë ishin Abaz Hado dhe Dritan Sejko. Hado u zgjodh me 89 vota përballë 81 votave të kandidatit Sejko, teksa votuan delegatët nga të gjitha degët e shoqatës.

Dr. Abas Hado ka përfunduar studimet në Institutin e Lartë të Arteve, mban gradën doktor i shkencave

dhe është pedagog. Ai ka drejtuar me sukses institucione të rëndësishme në vend pas vitit 1990, si Galerinë e Arteve etj. Hado ka shërbyer si zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitet 2011-2013.

Shoqata "Çamëria" është e para e krijuar pas daljes në dritë të Partisë demokritike në dhjetor 1990. Çështja çame, me gjithë zhvillimet dhe këmbënguljen e këtij komuniteti, ka pasur edhe pengesa të shumta si pasojë e lobingut grek në Shqipëri si dhe si një kërkesë e Athinës zyrtare që të mos e njoh çështjen çame. Kjo edhe për faktin se mbi shtetin grek rëndon një genocid i pafalshëm në mbarim të Luftës II Botërore, pas atij 27 qershori të vitit 1944 kur në Paramithi nisi fushata antishqiptare me gjakatarë, me 3 mijë të vrarë dhe më pas edhe 3 mijë të tjerë që vdiqën rrugës dhe në vendqëndrimet në Kllogër të Konispolit nga keqtrajtimet e shumta.

DOSSIER

Holokausti dhe Besa e Shqiptarëve, historitë e jashtëzakonshme


Në ditën e përkujtimit të viktimave të Holokaustit, Asmbasada e SHBA në Tiranë ka risjellë në vëmendje faktin se Shqipëria është ndër vendet e vetme që ku hebrenjtë nuk u diskriminuan, por u mbrojtën gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në faqen zyrtare të ambasadës amerikane në Facebook shkruhet:

"Në vitin 1934, Herman Bernstein, Ambasadori Amerikan në Shqipëri shkruante: "Nuk ka asnjë gjurmë diskriminimi të hebrenjve në Shqipëri, sepse Shqipëria është një nga vendet e rralla në Europë sot ku paragjykimi fetar dhe urrejtja nuk ekzistojnë, edhe pse vetë shqiptarët janë të ndarë në tre besime fetare."

Në nderim të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, ne do të ndajmë me ju historitë e shqiptarëve që shpëtuan hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke dëshmuar mirësi njerëzore dhe traditën unike shqiptare të besës.

Më poshtë mund të lexoni disa nga historitë sesi u shpëtuan hebrenjtë në Shqipëri.



Në prill të vitit 1941, djaloshi 7 vjeçar Jasa Altarac po vizitonte gjyshen e tij në Sarajevë. E gjithë familja ishte mbledhur për festën hebreje (Passover). Papritmas, zhurma e bombardimeve çau ajrin dhe familja vrapo për në bodrum. Shtëpia u godit. "Mbah mend që fluturova në ajër shumë lart dhe më pas rashë përtokë. Motra ime Lela u gjend së bashku me gjyshen time. Kishin vdekur."

Pas varrimit, Jasa me prindërit e tij u kthyen në Beograd. "Gjermanët kishin mbërritur edhe aty, sigurisht. Në të gjithë qytetin posterat njoftonin se kush do të ndihmonte hebrenjtë do të ekzekutohej. Të gjithë hebrenjtë duhet të paraqiteshin në rajonin e policisë. Kështu im atë u dorëzua dhe u dërgua në punë të detyruar."

Familja vendosi të largohej për në Shqipëri, duke qenë se ishte nën juridiksionin Italian dhe "italianët nuk i persekutonin hebrenjtë."

Kur forcat pushtuese naziste mbërritën në vend, familja Altarac vendosi se do të ishin më të sigurtë në një qytet të madh si Tirana. Ata u strehuan nga familja e Atif dhe Ganimet Toptanit. Ishin kohë të rrezikshme, gjatë të cilave gjermanët ishin në kërkim të hebrenjve. Por familjet hebreje u mbrojtën nga shpëtimtarët dhe fqinjët e tyre. E

gjithë e dinin dhe askush nuk tregoi. "Njerëzit trokisnin në dyer në mes të natës. Ata i strehonin. Ata u jepnin ushqim. Ata i qetësonin. Thoshin 'rini të qetë. Nuk do t'ju ndodhë asgjë e keqe. Do t'ju mbrojmë ne. Do ju duhet të na vrasin në përpara se t'ju vrasin ju.'"Ndiej mirënjohjen më të madhe për këta njerëz. Shqiptarët janë njerëz të mirë."



Shtëpia jonë është në Pukë. Im atë kishte një dyqan me ushqime. Ishte i vetmi dyqan i tillë në të gjithë zonën. Një ditë, një transportues gjerman kaloi pranë, me nëntëmbëdhjetë të burgosur shqiptarë që po shkonin drejt punës së rëndë, dhe një hebre, i cili do të ekzekutohej. Im atë, i cili fliste shumë mirë gjermanisht, i ftoi gjermanët në dyqan dhe u ofroi ushqim dhe verë. Ai u dha verë derisa ata u dehën.

Ndërkohë ai fshehu një shënim prenda një pjeperi dhe ia dha djaloshit hebre. Aty kishte shkruar udhëzimet si të hidhej nga makina dhe të fshihej në pyll në një vend të caktuar. Gjermanët u inatosën nga arratisja por im atë u tha se ishte i pafajshëm. Ata e morën tim atë në mes të fshatit dhe e lidhën në një mur për ta bërë të tregonte se ku fshihej djaloshi hebre.

Katër herë ata i vunë pistoletën në kokë. Ata u kthyen duke kërcënuar se do ti vinin flakën gjithë fshatit nëse im atë nuk tregonte. Por im atë nuk u dorëzua, dhe ata më në fund ikën.

Im atë e mori djaloshin nga pylli dhe e strehoi në shtëpinë e tij për dy vjet derisa lufta mbaroi. Emir i tij ishte Yeoshua Baruchoiç. Ishim 30 familje në fshatin tonë po askush nuk e dinte se im atë strehonte një hebre. Yeoshua është ende gjallë. Ai është dentist dhe jeton në Meksiko.



Orhan Frashëri sapo kishte mbaruar shkollën e mesme dhe punonte si logaritar kur italianët pushtuan Shqipërinë në 1939. Babai i tij, Halili, e hapi shtëpinë e tyre të madhe në Berat për partizanët që luftonin ndaj pushtuesve. Drejtori i kompanisë ku Orhani punonte e kërkoi në zyrë.

"Ai më kërkoi të plotësoja një formular anëtarësimi në parti të fashiste, të cilin unë e refuzova. Më pas më pushuan nga puna. Shtatë anëtarë të familjes time dhe unë iu bashkuam lëvizjes partizane për çlirim."

Familja e Orhanit ishin bektashi. "Im atë ishte shumë besimtar. Ai i ndiqte të gjitha zakonet. Edhe xhaxhallarët e mi ishin gjithashtu besimtarë."

Një ditë, një mik i tij i tregoi babait të Orhanit për tre familje hebreje që po fshiheshin nga nazistët. "Babai i futi në shtëpi dhe i strehoi në katin e dytë, u dha krevatë, dyshekë, batanije, pjata, çdo gjë. Ata kërkuan që të pagonin për to por im atë nuk pranoi. Ata kishin bizhuteri, dhe meqënësi im atë nuk pranoi para, ata u munduan që të paktën të merrte ato. Por ai u tha se ne do të kujdeseshim për çdo gjë."

Disa nga komshinjtë e Orhanit u habitën se si një besimtar fanatic si babai i tij strehoi hebrenjtë. "Por babai u tha se pikërisht sepse ishte besimtar, sepse ishte bektashi, ne do ti hapnim dyert për ta. Besimi nuk ishte pengesë në shtëpinë tonë. Rreziku i

vërtetë ishte se duke pasur ata në shtëpi ishte sikur të kishim një bombë me sahat. Ata ndiqeshin këmba këmbës. Por ne i pranuan pavarësisht pasojat që do mund të kishim nëse gestapoja do ti gjente."

Orhani mendon se vullneti i babait për të strehuar famil-

jet hebreje ka lidhje me kodin e nderit shqiptar, besën. "Fjala e dhënë e shqiptarëve, besa, është më e vyer se ari. Përpara se të betohen mbi flori, shqiptarët japin fjalën, besën e tyre. Një shprehje e jona thotë 'shqiptari vret djalën përpara se të thyejë fjalën.'

"Unë jam djali i madh i Nuri Hox-



hës, i cili ishte shumë i njohur si mësues dhe besimtar mysliman këtu në komunitetin tonë në Vlorë. Më kujtohen ato kohë të tmerrshme kur nazistët erdhën në Vlorë nga Greqia, dhe hebrenjtë nisën të fshiheshin. Unë isha 10 vjeç. Hebrenjtë në Vlorë, Berat dhe Elbasan jetonin këtu në Shqipëri qysh prej vitit 1490, dhe shumë prej tyre erdhën këtu nga Janina e Greqisë.

Babai im strehoi 4 familje hebreje. Të gjithë ata ishin miqtë e tij. Më kujtohen fjalët e tim eti kur iu drejtua atyre që kishte strehuar: "Tani jemi një familje. Ju nuk do t'ju ndodhë asgjë. Djemtë e mi dhe unë do t'ju mbrojmë ndaj çdo rreziku edhe me jetën tonë."

I fshehëm familjet në bunkerët nën tokë që lidheshin me shtëpinë tonë të madhe. Aty ishin tre breza nga familjet e Ilija Sollomonit dhe Mojsi Negrin, gjithsej 12 veta. Kishte edhe të tjerë të cilëve nuk ua mbaj mend emrin. Bunkerët ishin të lidhur me njëri-tjetrin dhe kishin shumë dalje për arratisje. Detyra ime ishte që t'u çoja ushqim familjeve në bunker dhe të blija gjërat që u duheshin. Të gjithë banorët e Vlorës ishin anti-fashistë dhe të gjithë e dinin se shumë familje strehonin hebrenjtë.

INTERVISTA

Ministria Kodheli flet për aksionet që po ndërmer Ministria e Mbrojtjes në aspektin e modernizimit të FA

Shqipëria është një vend i sigurt

Kodheli: "Shqipëria është një vend i sigurt, por kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht është një vend imun ndaj fenomenit të terrorizmit"

Zonja ministre, cilat janë politikat dhe aksionet që po ndërmer Ministria e Mbrojtjes në aspektin e modernizimit të FA?

Fillimisht ne rregulluam dhe amendojmë gjithë kornizën ligjore që lidhet me zinxhirin e komandimit. Këtë hap na e bëri më të domosdoshëm fakti që Shqipëria prej 5 - 6 vitesh ishte anëtare e NATO dhe mjaft çështje që lidhen me këto nuk ishin reflektuar në ligj. Mbas kësaj, pas miratimit të të gjithë dokumentacionit strategjik që lidhet me aktivitetin e FA për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, ne na u mundësua vënia në praktikë e këtij dokumenti duke filluar me modernizimin. Modernizimi është një proces i rëndësishëm, relativisht i panjohur më parë. Është hera e parë që Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes blen armatim dhe municion të standardeve NATO, që është totalisht krejt i ndryshëm nga ai çka ushtria shqiptare dispononte më parë. Dhe kjo sigurisht është një fillësë e re, është një fillim i mbarë dhe është pikërisht atje ku ne duhet të shkojmë. Ky është viti i dytë që ne jemi duke e bërë këtë proces. Ne kemi detyrim në raport me NATO të përgatimis Bataionin e Dytë të Këmbësorisë (b2k) për misionet dhe operacione ku NATO e kërkon. Sigurisht këtë e bëjmë më së pari për veten tonë dhe pastaj për faktin e të qenit pjesë e një Alliance më të rëndësishme politiko - ushtarake në botë. Dhe kemi filluar me armatimin, me pajisjen individuale të ushtarakeve, kjo sigurisht shoqërohet nga ana tjetër me një trajnim dhe edukim më të mirë të ushtarakë, si dhe me një investim modest që ka të bëjë me ruajtjen e këtij armatimi dhe këtij municioni dhe sigurisht edhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Dua të them se, prej 25 vjetësh nuk ishte paguar asnjë lek për të mundësuar një ristrukturim dhe infrastrukturë të tillë, gjë që jemi duke e bërë me hapa të ngadalte, por të sigurt. Dhe kjo besoj që na bën krenarë të gjithëve, na bën krenarë në për suksesin e punës, por sigurisht që bën krenar edhe vet popullin shqiptar dhe Shqipërinë që sot ka një ushtri më profesioniste dhe më të mirëpajisur.

FA kanë edhe një detyrë tjetër, po themi në kohë paqe, angazhimet në emergjencat civile. Cilat janë ndërhyrjet që po ndërmer FA, kemi parasysh përmirësimin e vërshtirë pas përmbytjeve?

Më së pari, qeveria mori një vendim të rëndësishëm për krijimin e disa strukturave të përbashkëta, të cilat do të mundësojnë një përgjigje më të shpejtë edhe më efektive gjatë periudhave të emergjencave civile. Ushtria nuk është në rreshtin e parë të përgjigjes, sepse duhet të ketë disa kushte kur ushtria hyn dhe ndërvepron. Por përtej kësaj, FA, ashtu siç edhe e kemi parë vetë nëpër kronika që keni qenë ju dëshmitarët më të parë, kanë qenë në të gjitha zonat ku ka pasur probleme me përmbytjet, me të ftohtin, me borën, me zjarret nëpër pyje, duke treguar që janë aty sa herë që nevojë e kërkon, sa herë që qytetarët e kërkojnë. Vazhdojmë të kemi përmirësim të strukturave të emergjencave civile, duke pasur edhe bashkëpunimin me MPB, por sidomos me pushtetin lokal dhe, t'u them të drejtën, gjëja e parë që kam vënë re gjatë gjithë vizitave të mia në të gjithë zonat ku trupat tona kanë qenë prezentë, ka qenë funksionimi i bashkëpunimit me strukturën e re të pushtetit vendor. Pra, ajo çka është vënë në zbatim sot bazuar në reformën administrative që ne bëmë, më rezultoi që është krejt pozitive, sidomos në rastin e emergjencave. Dhe ky bashkëpunim e bën akoma më efektive ndërhyrjen. Fakti që ne kemi ndërhyrë me forcë, me shpejtësi dhe atje ku duhet, duke përdorur gjithmonë dhe më pak, le të themi



burime, me një rezultat më të mirë, na bën të besojmë që ky bashkëpunim ka funksionuar dhe do të vazhdojë të përmirësohet në të ardhmen. FA kanë një pjesë të rëndësishme si të punës ashtu edhe të suksesit në këtë rezultat.

Pak ditë më parë përfundoi asgjësimi i municioneve të tepërta, pas 15 vitesh punë. Janë eliminuar mbi 100 mijë ton municione të mbetura. Si do ta konsideroni këtë fakt dhe çfarë rrezikoni nëse ky proces do të shtyhet?

Në fakt, po ju them se mua më takoi që të jem pjesë e ceremonisë së mbylljes së këtij procesi të rëndësishëm, por në 15 vjet më duhet të falënderoj të gjitha strukturat që kanë marrë pjesë dhe jo vetëm strukturat e FA, të MM, por edhe donatorët, duke filluar që nga SHBA deri tek Danimarka e Gjermania më së shumti, të cilat kanë qenë pjesë e këtij procesi. Shqipëria ka pasur jo vetëm armatime dhe municione të tepërta, që sidomos gjatë vitit famëkeq '97 u keqpërdorën, u përdorën nga njerëz që nuk duhet të përdorëshin, u trafikua etj. Domethënë, mundësia për të rënë në dorë të keqbërësve, të terroristëve, ishte gjithmonë dhe më e madhe. Kështu që procesi i mbylljes nuk ka rëndësi vetëm për sigurinë e mjedisit tonë, të qytetarëve, por njëkohësisht ka shumë rëndësi për vendet në përgjithësi, të rajonit dhe më shumë se sa kaq. Sepse fakti që ky material i tepërt, i ekzagjeruar, i panevojshëm, mund të binte në duar të keqbërësve, të keqdashësve, kishte një probabilitet të madh nëse do të ishte atje. Sot nuk është më asgjëkund, ashtu siç edhe ju thashë, armatimet dhe municionin i ri fle, rri, ruhen në vende shumë herë më të sigurta, me standarde, realisht me standard të NATO dhe kjo na bën të ndihemi krenarë dhe të sigurt jo vetëm ne, por edhe qytetarët, sepse kjo është gjëja më e rëndësishme. Ky ishte ndoshta procesi më i suksesshëm që FA kanë bërë jo vetëm në 15 vitet e fundit, por gjatë gjithë historisë së tyre të tranzicionit. Dhe duhet në fakt të përgëzohen për këtë të gjithë ata që kanë qenë pjesë. Duhet që nga ky proces të marrim leksionet që na duhen dhe sigurisht ne po vazhdojmë të mbyllim të gjithë pikat ku kjo shpërbërje ka ndodhur dhe në këtë mënyrë t'i rikthejmë ato në ambiente të nevojshme për njerëzit, apo pse jo, dhe në mjedis të tilla si zona të mundshme për të mbjellë pemë, për t'u kthyer në pyje; pra edhe në ndihmë të mjedisit. Në fakt, ekspertiza jonë në këtë fushë është për t'u konsideruar në nivele ndërkombëtare. Dhe kjo na bën të besojmë që ne mund të kthehemi nesër edhe në një qendër të shpërbërjes së municionit edhe për vende të tjera që e kanë problem këtë. Ju them që

çdo vend rreth nesh dhe më shumë se kaq, ka probleme të tilla. Sigurisht që ka disa vende, për shkak të teknologjisë së lartë që ata disponojnë, që e bën këtë edhe për vende të tjera. Gjermania, për shembull, është një vend që shpërbën lëndë kimike të rrezikshme dhe të një rrezikshmërie të lartë, jo vetëm për Gjermaninë, por për shumë vende europiane. Ne mund të kthehemi, bazuar në strukturën që disponojmë akoma dhe në ndërmarrjet tona ushtarake, në një vend ose në një qendër që mund të japim ekspertizë për të tjerët, apo mund ta bëjmë këtë edhe për të tjerët, kundrejt të ardhurave. Ne kemi bërë në fakt suksesshëm një projekt pilot me Malin e Zi, ka qenë krejt modest, por që na ka bërë në të rivlerësojmë dijet tona dhe nivelin tonë të ekspertëve dhe të marrim certifikatat e nevojshme nga strukturat ndërkombëtare për të qenë të gatshëm ta ofrojmë këtë shërbim edhe të tjerëve. Është një proces në vlerësim, do ta shikojmë në vazhdim se çfarë do të ndodhë.

Znj. ministre, ju thatë pak më parë për rrezikun që mund të sillnin armët, n.q.s. nuk do demontoheshin, në këtë luftë të tmerrshme globale kundër terrorizmit. Shqipëria sa mund të rrezikojë në këtë çmënduri globale që quhet terrorizëm?

Shqipëria është një vend i sigurt, por kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht është një vend imun ndaj këtij fenomeni. Kjo kryesisht për dy arsye: E para, sepse Shqipëria është një vend i NATO dhe si vend i tillë mbart dhe sigurinë por edhe rrezikshmërinë, në raport me këtë fenomen, me atë që ju e quajtet me të drejtë çmënduri globale, që s'ka lidhje me fenë, që s'ka lidhje me të drejtat e njeriut, që s'ka lidhje me racën njerëzore në përgjithësi dhe, së dyti, Shqipëria dhe territoret shqiptare rreth saj po ashtu dhe Bosnje - Hercegovina (do e fusja në këtë diskutim) fatkeqësisht janë burime të ashtuquajturës luftëtarë të huaj. Dhe kjo e bën të rrezikuar sigurinë e Shqipërisë. Problemi nuk është thjesht përse këta njerëz largohen kur lufta s'është e tyre (vendit të tyre), por problemi është se kur ata kthehen në vendin e tyre, pranë familjeve, kush është qasja e tyre në shoqëri, në familje dhe më gjerë se kaq. Pra, cila është ideologjia që ata sjellin tashmë me ekspertencën e tyre. Sigurisht kjo na bën më alert, të perfeksionojmë teknikat, mënyrat, se si e kemi qasur këtë fenomen dhe jo vetëm ne si FA, por të gjitha strukturat që merren me sigurinë e Shqipërisë, duke filluar që nga Ministria e Brendshme, Policia, trupat kundër terrorizmit, shërbimet informative e kështu me radhë. Sigurisht ka një bash-

këpunim dhe shkëmbim informacioni midis nesh dhe më shumë se kaq. Kjo është një luftë e padrejtë, asimetrike, por që na lë në gatishmëri dhe kjo është detyra jonë, për t'i siguruar qytetarët e vendit që ata mund të vazhdojnë jetën të qetë, jetën familjare të tyre, aktivitetin e tyre, sepse është dikush që merret seriozisht me këtë punë mbrapa kuintave.

Ju jeni ministre, por edhe një politikane. Atëherë si e shikoni ju punën dhe performancën e qeverisë? Mendoni se në mes të mandatit mund të ketë nevojë për një rifreskim?

Unë besoj që ka dy njësi matjeje puna e një qeverie. Atë çka ti ke thënë se çdo të bësh dhe atë metrin me të cilin mat veten. Personalisht unë jam një njeri që nuk kënaqem asnjëherë me gjërat që bëj. Ndofta kjo është një shtysë, një motor shumë i fuqishëm që më bën mua çdo ditë të bëj më shumë dhe më mirë. Nuk ka të bëjë me këndvështrimin pesimist të asaj që unë bëj çdo ditë apo të botës që më rrethon, ka të bëjë me një shtytje që më lejon në gjykimin tim të bëj gjëra çdo ditë. Kjo duhet të jetë në fakt një arsye më tepër dhe një motor edhe për qeverinë, sepse qeveria duhet të jetë gjithmonë e pakënaqur. Lideri i qeverisë, kryeministri Edi Rama, është gjithmonë i pakënaqur me punën tonë, sepse kërkon gjithmonë e më tepër dhe nga vetja. Kjo për mua është normale që të jetë kështu. Nuk di t'u them se është në gjykimin e kryeministrit nëse në fund të ditës ai mendon që gjërat që janë vënë si target për t'u mbërritur nga ne janë bërë apo jo. Unë mund t'u siguroj që e parë nga jashtë ka një gjykim të vetin, e parë nga brenda mund të ketë një këndvështrim tjetër të të bërit të punës. Dhe përta përket Ministrisë së Mbrojtjes, megjithë që unë kam qenë e involvuar në politikë, e involvuar në punën parlamentare më përpara si opozitar, nuk kam menduar kurrë që gjë të paktën nga pikëpamja financiare gjëra të bëra kaq keq, para të shpenzuara dhe të hedhura dëm, borxhe kaq të mëdha. Kam ditur shumë gjëra, por nuk i kam ditur të gjitha dhe sigurisht kur unë kam ardhur këtu dhe kam thënë që unë do të bëj pesë gjëra, kam kuptuar që për shkak të situatës që kam gjetur kam mundur të bëj vetëm kaq. Dhe kjo në fakt i duhet shpjeguar mirë publikut, nuk e di se sa kemi qenë në gjendje ta bëjmë këtë gjë, por unë ju siguroj se serioziteti me të cilin ne kemi punuar në këto 2 vjet e gjysmë do të vazhdojë të jetë maksimal edhe në të ardhmen. Dhe në ka një gjë që ka ndryshuar është vënia në qendër e njeriut, e individit, diskutimi jo vetëm për vendin e punës, për varfërinë, për punësimin që janë të dhëna çelës për një ekonomi, por edhe diskutimi për bukën, edhe diskutimi për rregullin, edhe diskutimi për moralin, të cilat janë elementet që në dukje të parë duken si gjëra sekondare, por në fakt të tilla nuk janë. Ndaj unë e vlerësoj punën, nuk do të thosha timen, sepse duhet të jetë dikush tjetër që ta vlerësojë atë, po të kolegëve të mi, maksimalisht. Unë kam parë impemjimin e tyre dhe seriozitetin e tyre në diskutim të çështjeve madhore, por pse jo edhe të çështjeve të vogla, maksimal. Pastaj është në gjykimin e kryeministrit Rama për të parë se si kjo gjë ecën në dinamikë dhe sigurisht që personalisht, siç mirëpres gjykimin dhe paragjykimin ndonjëherë dhe të rëndë të publikut, ashtu për dhe gjykimin e tij. Unë jam krejt e qetë, besoj që detyrat e shtëpisë i kam bërë mirë, jam mësuar të jem nxënëse e mirë, nuk e di në këtë rast nëse do të vazhdoj të jem e tillë apo jo.

(Nga intervista e Ministres së Mbrojtjes, Znj. Mimi Kodheli, dhënë për "VIZION + " më 25 janar 2016)

IN MEMORIAM

Që nga koha që ekziston qytetërimi, askush s'ë ka ndryshuar ecurinë e historisë sa historianët

MUSTAFA GJINISHI -

Ngja Shpendi TOPOLLAJ

Fakti që edhe pse kanë kaluar gjashtëdhjetë vjet dhe historiografia jonë ende ngurron, për t'i dhënë vendin që i takon, figurës së ndritur si rrezja e diellit, të atdhetarit të shquar Mustafa Gjinishi, gjë që ka nxitur mësuesin e elektronikës Astrit Kaziu, të bëjë të vetën atë devizën romake "Vivam impendere vero", pra "T'ia kush-tojë jetën shërbimit të së vërtetës", më kujtoj thënjën e mençur të Emil Herzogut, të njohur si Andre Morua që kur e pyetën se:

-Cili e ka ndryshuar më shumë ecurinë e historisë Çezari apo Napoleoni?

U përgjigj:

-Që nga koha që ekziston qytetërimi, askush s'ë ka ndryshuar ecurinë e historisë sa historianët.

Mirëpo kur flitet për ngjarje dhe njerëz të kohëve jo shumë të largëta, edhe po nuk e përfille porosinë e Ciceronit se "Ligji i parë i historisë është të mos thuash kurrë asgjë të rreme dhe të mos kesh frikë të pohosh tërë të vërtetën", përsëri roli jo shumë i nder-shëm i historianëve (qoftë dhe heshtja e qëllimshme e tyre) sikur e humbasin kuptimin, pasi para kujtesës popullore, djallëzia dhe mungesa e kurajo-tytaret, zbehen. Duke dashur t'a mbyllë një herë e mirë këtë problem përherë të hapur, Aristoteli, konkludonte se "As Perënditë nuk mund t'a ndryshojnë historinë". Dhe ndryshimi i historisë do të që një mëkat i madh, kur bëhet fjalë për një bir të Peqinit që i bën nder gjithë Shqipërisë, i cili me jetën dhe veprën e tij në shërbim të lirisë së atdheut, ishte më shumë se hero; ai ishte i drejtë. Se është ashtu siç thotë L. Pirandello, që hero mund të jesh një herë, kurse i drejtë duhet të jesh gjithmonë.

E kam ndjekur me shumë interes jetën shumë tërheqëse dhe fatkeqe njëkohësisht, të Mustafa Gjinishit. Më kanë lindur shumë pyetje e dyshime rreth trajtimit zyrtar që i është bërë atij. Libri i Astritit, më dha shumë përgjigje dhe më sqaroi në mënyrë të pa kundërshtueshme shumë paqartësi. Tani ky njeri i rrallë që veç epitetëve të tjera të merituar, është quajtur edhe Leonida, më ngjet më shumë me Aristidin, i cili për drejtësinë dhe ndershmërinë e tij u dënua me ostracizëm, dënim që u jepej sipas Demetrit nga Faleri, atyre që ishin nga një derë e madhe dhe që me shkëlqimin e tyre ngjallnin admirimin e të tjerëve. Plutarku pasi e konfirmon këtë e portretizon këtë burrë shteti të lashtësisë me këto fjalë që do t'i shkonin për mrekulli Mustafa: "Kurrë nuk u fry nga nderet që i bëheshin, me qetësi e gjakftohtësi përballoi edhe ditët e vështira, i bindur se duhej t'i shërbente atdheut pa prituri shpërblime as në para, as në nderë".

Por ashtu si për këtë njeri me moral të shëndoshë, doli në skenë dinaku Temistokli, që s'la gur pa lëvizur për t'i vrarë atij reputacionin edhe për Mustafa Gjinishin, që e mjaftueshme dika kështu e Enver Hoxhës, për t'a vrarë



e për t'a lënë pa varr, në moshën 32 vjeçare. Tinzar, hileqar, dhe i pabesë siç që, Enver Hoxha me intrigat e tij, shkante përtej fantazisë shekspiriane. Edhe kur pas përbetimit të Kilonit, u dënua familja e Megakliut dhe atyre që kishin vdekur, ju hapën varret dhe ju flakën eshtrat jashtë kufijve të vendit, të paktën u bë një gjyq i rregullt dhe e dha verdiktin një trupë e përbërë nga treqind veta të zgjedhur nga paria.

Mënyra e fshehtë me të cilën u likujdua Mustafa Gjinishi, përbën një pengesë serioze për cilindo që kërkon të shkruaj rreth tij. Konkluzionet hipotetike janë pa pranueshme. Prandaj autori përballet me një përgjegjësi shumë të madhe. Rruga për tek e vërteta është e gjatë dhe e vështirë. Ajo kërkon ndershmëri, kurajo, vullnet dhe natyrshëm, metodë të efektshme. Por mbi të gjitha kërkon mendje analitike, që të operosh me deduksione dhe induksione. Ne e dimë që këto dhunti i kishite maksimalisht të arrira S. Cva-jgu. Natyrisht, A. Kaziu është larg të qenit Cvaigj. Ca më shumë që ky është libri i parë i tij, për të cilin ai vetë pohon... i u futa punës të shkruaj vetë për jetën, veprën e sidomos harresën e tij, megjithëse nuk jam as shkrimtar e as historian". E më tej ai vazhdon të shprehjet sinqerisht "Këtë libër po e bëj me dëshirën si nip i tij, por dhe si qytetar i Peqinit, thjeshtë për t'i thënë lexuesit të vërtetën e të madhit Gjinishi, por sidomos edhe për të treguar atë ç'ka është paradoksale sot, në mohimin me heshtje të qëllimshme të veprës së tij". Dhe këtë qëllim fsnik, Astritit e ka realizuar më së miri.

Edhe pse autori nuk e ka jetuar atë kohë, përsëri ai ka bërë të mundur pasqyrimin objektiv të saj në sytë e lexuesve. Ai e përshkruan Peqinin e atyre viteve në mënyrë bindëse. Po ashtu peqinasit paraqiten të thjeshtë dhe shumë atdhetar. Edhe familja e Mustafait e sidomos aktiviteti i babait t'ë tij Ademit që kishte shoqëruar karvanin e I. Qemalit dhe që zgjedhur delegat në Kongresin e Lushnjës, na

përgatisin për formimin e karakterit të protagonistit të këtij libri, të cilin një i afërt i mençur e quante zheni. Pas këtij momenti mënyra e të shkruarit, alternohet me kujtimet e motrës së Mustafait, hallë Xhemiles, tashmë të moshuar që nuk ankohet për vuajtjet e mëdha e të pa merituar që ka hequr gjatë jetës, por që e revolton harresa dhe heshtja për të vëllanë bashkëluftëtar, ç'ka e shtyn të pyes: "Po ku e kanë hallin xhanëm? Akoma e kanë frikë Enverin!?"

Mustafai që i vogël që i etur për dije. Ai lexonte shumë libra dhe mëson-te gjuhë të huaja. Kur u vra babaj i tij, Mustafa gjëmbëdhjetë vjeçar pat kujdesin e të vëllait Rexhepit, i cili e dërgoi për të vazhduar studimet në Shkollën Teknikë të Fulcit në Tiranë. Qysh në bangat e kësaj shkolle, ai manifestoi inteligjencë e pjekuri, aq sa fitoi autoritet të jashtëzakonshëm tek nxënësit e tjerë dhe tërhoqi vëmendjen, bile fitoi admirimin e vetë Harri Fulcit. Në libër thuhet se ai respektohej nga shokët si pedagog dhe pedagogët e trajtonin si koleg. Ky djalë që fare i ri lexonte me shumë pasion Volterin, Rusonë etj ky djalë që zotëronte anglishten, gjermanishten, frëngjishten, italishten e serbokroatishten, kur djalë, për të cilin, drejtori thosh, ky e shihte të rreshtonte e këshillonte të tërë shkollën "Zot fale këtë njeri!" jo vetëm që drejtohte me shumë kompetencë gazetën "Laboremus", të cilës në mars të vitit 1929 Shoqata e shtypit shkollor të universitetit "Kolumbia" në Amerikë i dha çmimin e parë të gazetave të shkollave të paraqitura nga vende të ndryshme të botës, dhe që nxorri me sukses dhe revistën letrare-shkencore "Shekulli XX", edhe pa mbarimit të shkollës më 1930, vazh-donte të ishte drejtues në organet e zgjedhura të shkollës, ku në çdo fund viti do të ishte i pranishëm e do të fliste, siç kishte folur përherë, si erudit, demokrat, tolerant e mbi të gjitha, si patriot. Ne emër të këtij patriotizmi, Mustafai përqafoi shumë shpejt idetë komuniste aq në modë në atë periudhë. Atë dhe shumë të tjerë i joshite romantizmi revolucionar. U. Çerçilli një herë ka thënë se "Kush e ka lexuar Manifestin Komunist në moshën 18 vjeçare dhe nuk është bërë komunist-nuk ka zemër. Kush e ka lexuar në moshën 25 vjeçare dhe është bërë komunist-nuk ka tru". Kur përvehtëson-te dhe përhapte komunizmin, Mustafai gjykonte ende me zemër. Kur ai nisi t'i peshojë gjërat me tru, vendi që pushtuar dhe bashkimi me Partinë Komuniste identifikohet me çlirimin dhe të ardhmen e vendit. As ai e as kush tjetër nuk mund të quhen mëkatarë, pse u besuan ndershmërisht atyre ide-aleve. A. Kaziu edukimin dhe formimin e Mustafait na e ka dhënë realisht: heroi i librit të tij dhe i kombit tonë, ishte larg verbërisë ideologjike, dogmatizmit e sektarizmit. Ca më shumë, ai as që e kuptonte komunizmin si luftë deri në vdekje me vendet dhe demokracinë perëndimore. Aktiviteti i Mustafai Gjinishit duket edhe në do-

kumentet që na ka paraqitur autori, në këtë liber, por edhe në dënimet e burgosjet që i bëheshin atij nga regjimi. Madje, kur atë pas kryengritjes së Fierit e dënuan me varje, që pleqësia e qytetit te tij, që duke e dashur shumë këtë djalë të ish Kryetarit të Bashkisë, patriotit Adem Gjinishi, i shpëtoi jetën duke ju lutur Mbretit me një telegram sugjestionues. Mustafai qëndron në burg, por nuk nënshtrohet. Kujtimet e Petro Markos me shokë, të qëmtu-ara nga autori me aq durim, na e vërtetojnë më së miri këtë. Përkushtimi i Mustafait ndaj çështjes së popullit, duket qartë edhe tek fakti se pas vdekjes së të vëllait, për të cilin ai bëri çka mundi për t'a shpëtuar, duke e shoqëruar edhe jashtë shtetit, edhe pse i mbeti e vetmuar e motra, përsëri nuk hoqi dorë nga angazhimi i tij politik e luftarak edhe pse ishte i ndërgjegjshëm për rreziqet që e prisnin. Për më tepër, ai diti të tërheqë atë në lëvizjen për liri. Ja një pjesë e dokumenti e marrë në AQSH, nga koha kur ajo që studente në Itali: "Zonjusha Xhemile Gjinishi ...nuk ka në vendlindje asnjë nga pjestarët e familjes sepse i kanë vdekur përveç një vëllai, Mustafa Gjinishi, që është anti-italian i rreptë... (Molto pericoloso). Kur të kthehet në Shqipëri ndaj zonjushës Gjinishi do të disponohet një vigjilencë e duhur".

Para pak ditësh më erdhi në zyrë gjenerali i njohur në pension Ernest Jakova. Kur i thashë në e kishte njohur Mustafa Gjinishin dhe a mund të më thosh ndonjë gjë për të, m'u përgjigj se e kish patur komisar në Pezë, por nuk mbante mend shumë gjëra për të, pasi ai pa ardhur mirë në çetë, zhdukej për ditë të tëra, atje ku e prisnin detyra shumë më të rëndësishme, pasi ai i përkiste gjithë Shqipërisë. Astrit Kaziu, me fakte të njohura botërisht, me dokumente e fotografi, na e jep portretin e Mustafait, si një nga drejtuesit dhe organizatorët më energjikë e më të përgjegjshëm të luftës nacional-çlirimtare. Ja si shkruan ai për të: "Meritë e veçantë e Mustafait në luftë që se ai, krahas aktivitetit të tij për ngritjen e njësiteve dhe formacioneve ushtarake...apo të krijimit të këshillave naç-çl. në zonat e çliuara, në veçanti nuk pushoi së luftuari për të sheshuar kontradiktat ndërmjet forcave të ndryshme politike, për t'i bashkuar ato të gjitha, në luftë kundër pushtuesit...M. Gjinishi gjatë luftës vazhdimisht u mundua të shes-hojë mosmarrëveshjet politike të P. Komuniste, Legalitetit, Ballit Kombëtar e nacionalistëve, për t'i mobilizuar dhe organizuar në luftë".

Inteligjent dhe atdhetar i spikatur, Mustafai punoi si askush për bashkimin e tërë shqiptarëve kundër okupatorit, duke nuhatur qysh në fillim të këqiat që do t'i vinin Shqipërisë nga përçarja e lufta civile. Mustafa Gjinishi shpalosi me vendosmëri këtë qëndrim edhe në konferencën e Mukjes, ku ai u bë promotor i bashkimit parimor. Por duke mbështetur parrullën e Shqipërië Etnike, ai mori mallkimin e të dërguarit të P K Jugosllave dhe të

IN MEMORIAM

NJË HERO I HARRUAR

shërbëtorit të tyre të bindur E. Hoxhës.

Me shumë durim e logjikë të ftohtë, Astrit Kaziu ndërton tërë atë çka ngjau në Tapizë në 26 korrik dhe Mukje në 1-2 gusht 1943. Gjinishi mbajti atje atë qëndrim që do të mbante çdo njeri që i thosh vetes shqiptar. Ai ishte nga ata burra që e dinte mirë se ku janë kufijtë e Atdheut tonë.

Astrit Kaziu për asnjë çast nuk rrëmbehet nga vrulli i cilësive të pa përsëritëshme të Mustafait udhëheqës; ai na e jep atë në tërë madhësinë e thjeshtësisë të të qenit njeri. I çiltër, orator i mbaruar, njeri i sakrificës deri në vetmohim, ai mbetet në çdo situatë përfaqësues tipik i vetive më të mira të popullit tonë. Me shokët është rreptësisht njerëzor. Tek ai nuk ka kurrfarë ndjenje superioriteti në marrëdhëniet me të tjerët. Ai është imponues pa qenë aspak mendjemadh e fodull. Është i natyrshëm e aspak i shtënë. Dhe kjo del shumë e qartë në dashurinë që ka për të Bab Myslymi. A. Kaziu me vërtetësi na ka dhënë këtë

DRAGOIT TË DETIT ADEM REKËS

I lindur më vitin 1927, Ademi do të lindi partizan në Br. e III - të S. Pasq lirimit të vendit, shkoi vullnetar nën dërritimin e Hekurudhës Durrës-Peqin.

Në vitin 1949 fillon punë në Flotën Detare e më vonë në Bigën lundruese.

U shqua vazhdimisht për ndërgjegje të lartë, për guxim dhe devotshmëri deri në sakrificë.

Ra heroikisht në mbrojtje të pronës së përbashkët, për të shpëtuar Bigën nga valët e të rruara të detit më 17 Nëntor 1966. Për këtë akt u shpall Hero i Punës.

Si kuçedra që përleshën
Përmbi Port valët vërshojnë
Por me Bigën sapo ndeshen
Me catrima do luftojnë.

Adem Rekën, i birë i Plakut
S'etremb dallgë, s'etremb rrufe
Vëllai Mujo Ulqinakut
Si dragua kishte le.

Dhe kur Bigën dot s'rrëmben
Zot i detit, Poseidon
Në zemrim të madh shpërthen
Në ballë trimin shigjeton.

Si lubi me dhëmbë skërmitur
Hidhen valet m'epëri
Porse Biga e pabindur
Nuk e jep, e mban nëgji.

Si zgalem në Port krenare
Do qëndrojesat jetë jeta
Biga jonë shqipëtare
Do mbaj emrin "AdemReka".



miqësi: keqardhjen e revoltën e Babës për vrasjen e Mustafait, dyshimet për pabesi, betimin për hakmarrje. Por ai shpjegon edhe rënjen e M. Pezës në kurthin e Enverit, deri atje sa tek libri "Kur dhashë besën" e quan Mustafanë që s'e ndante nga fëmijët e tij, tradhëtar. Për këdo që e njeh historinë e pasluftës së dytë botërore, është e qartë se vrasja prapa shpine e Mustafa Gjinishit, është prologu i tërë skenarëve mbushur me intriga e goditje të tilla, që Enveri u bëri gati të gjithë atyre që drejtuan luftën dhe udhëhoqën rindërtimin e vendit. Në këtë pikë ai, po të kishte jetuar 2-3000 vjet më parë, do të qe modeli më tërheqës i gjithë tragjikëve grekë. Astriti nuk merret me analogjira, edhe pse kjo në raste të tilla çon tek e vërteta. Ai kompozon skemën e kimit nëpërmjet analizave logjike e të pakontestueshme. Enveri i thotë Babës se Mustafai do pushkatuar. Ai e shpall atë fajtor për Mukjen. E quan Pezën, ku Mustafai qe caktuar, fole intrigash, sajion incidentin me Radio Londrën (që sipas tij i çon mesazh Tafarit, pra Mustafait, pasi ai duhej të qe agjenti i anglezëve), e çon me deçyrë Mustafain në Dibër, ku me anë të Liri Gegës e ka më të lehtë ta likujdojë, jo vetëm për të plotësuar dëshirën e jugosllavëve, por edhe për të larguar nga rruga e karrierës së tij politike mbushur me nënshtrime, një njeri të pa pajtueshëm me ambicjet e tij, një rival të mundshëm. Në kulmin e luftës ndaj okupatorit, E. Hoxha vazhdon i qetë intrigat e tij. Kështu veç shumë e shumë porosive, ja se ç'i shkruan ai

Liri Gegës... "Nuk dimë ç'bën Mustafai, e me kë piqet (në Dibër). Keni harruar krejt të na raportoni mbi atë zog të bukur". Dhe këtë zog të bukur, siç qe me të vërtetë ai, më 16 gusht 1944, një dorë mizore dhe e pa besë e qëllloi për vdekje, teksa fluturonte me guxim drejt qiellit të lirisë. Kërceu përpjetë nga gëzimi Enveri e Miladini, të cilin dikur duke rrezikuar jetën e tij, po ky Mustafa e pati nxjerrë nga burgu. Ishte një vdekje e dhimbshme dhe një humbje e pazvëndësueshme, të cilën Astriti, na e jep shumë afër asaj që ka ngjarë.

U vra në moshë fare të re, një luftëtar, një udhëheqës, një organizator, një orator e një patriot i madh, që me veprën e tij na kujton atë thënjën e Senekës se "Jeta është si një anekdotë; s'ka rëndësi sa e gjatë është: por sa është e vlefshme". Dhe këtë jetë të prerë në mes, A. Kaziu , e ka rindërtuar për bukuri, duke ballafaquar faktet, thënjët e logjikat e kundërta. Për më tepër ai di të flasë edhe për ndjenjat e Mustafait, tamam sikur të shkruante letërsi artistike. Dashuria për motrën dhe simpatia për vajzën e bukur me emrin Besa, përligjin vuajtjet shpirtërore e brengat e këtyre dy femrave.

Në vazhden e përpjekjeve të autorit për të shpjeguar mbiemrin Gjinishi, çfletova fjalorin e shqipes së sotme (viti 1984) dhe pashë se kështu qe një zbruktësi me thikë shumë ngushtë që përdoret për të hapur një vijë të thelluar anës drrasës, që gjithashtu quhet gjinish. Poetikisht mundet të mos jetë

krahasim i goditur, por duhet thënë se i tillë qe me vërtetë Mustafai, udhëheqës i një lufte të lavdishme, që gjithmonë kërkonte të çelte vija bashkimi për të gjithë shqiptarët, pavarësisht se ç'krahu i përkisnin. Ashtu siç i kërkonte të tilla vija bashkimi edhe në mes Shqipërisë, Kosovës e Çamërisë, ç'ka duket se qe dhe shkak i rëndësishëm për t'a vrarë mizorisht, si shumë të tjerë pas çlirimit të vendit. Po të mos qe e tillë rruga e përgjakëshme e Partisë komuniste dhe e shtetit diktatorial që pasoi, mund të ketë vend për dyshime rreth vdekjes së M. Gjinishit. Por e vërteta është e vërtetë. Dhe ne do të arsyetojmë sipas parimeve të saj. Drymondi diku thotë: "Kush nuk do të arsyetojë është një fanatik, kush nuk di të arsyetojë është i marrë, kush nuk guxon të arsyetojë është skllav i të tjerëve." Burrat e meçur të Peqinit në radhë të parë, do të dinë t'i shpëtojnë nderin Mustafai Gjinishit, ashtu sikurse dikur, baballarët e tyre e shpëtuan atë nga varja. Punët që fare mirë mund dhe duhet t'i bëjmë vetë, të mos u a lemë brezave që do të vinë, se do të na qortojnë para historisë. Astrit Kaziu dha një shembull të lavdërueshëm, për të cilin e përgëzojmë dhe e urojmë që t'a vazhdojë më tej. Ai tani ka një përvojë të suksesëshme dhe është në moshën për të cilën Servantesi thosh: "Të shkruash nuk është kurrë vonë. Dyzet vjetori është moshë e vjetër e rinisë, ndërsa pesëdhjetë vjetori është rinia e moshës së vjetër".

DOSSIER

“Se ky popull ka djem me huqe, Këmishën e zezë ta bëjnë të kuqe”

Maliq Topuzi, dhëndërr

Nga Shaqir Çerpja

Vapë, shumë vapë ishte. Ishte verë dhe ditët ishin shumë të nxehta, por as dhe netët nuk ishin të freskëta. Nuk qe vetëm vera e nxehtë, i gjithë viti qe i nxehtë. Dhe nuk dihej kush nxente më shumë atë mot: dielli përvëlues i verës apo flakët e nxehta të pushkëve, mitralozëve dhe bombave. Sepse kohë luftime ishte dhe lufta ishte në kulmin e vet. Lashkiza e ashpër, e rrethuar me male të larta dhe shkëmbinjë të sertë, nuk pati kohë të mendonte, të fliste, të bisedonte dhe të kuvendonte për arat dhe stanet, për pemët dhe bletët, për verën qe po ikte dhe për vjeshtën qe po vinte, por vetëm bëri apelin e djemve të saj, ua bekoj ditëlindjet te gjithëve, i bekoj dhe ata dhe u bëri thirrje t'i bashkoheshin luftës Nacionalçlirimtare, duke u rrjeshtuar në rradhët e brigadave partizane. Dy vëllezërit e Imer Topuzit, Selman dhe Met Topuzin, moshë më shumë i afrohte me nipin e tyre, djalin e Imerit, Maliqin, se sa me vëllan e tyre të madh, Imerin. Ato ditë, në familjen e tyre ishte folur dhe biseduar shumë për luftën. Kishin vendosur që edhe familja e tyre t'i bashkohej direkt luftës Nacionalçlirimtare. Atë natë në mbrëmje, të dy vëllezërit, Selmani dhe Meta, vetëm për vetëm, pa dijeninë as të Imerit dhe as të Maliqit, kishin folur përsëri për këtë problem dhe secili prej tyre kishte këmbëngulur që do të shkonte vetë partizan, por të dy kishin vendosur që, Maliqi, të qëndronte në shtëpi dhe të kujdesej për familjen. Kjo, ndoshta, edhe sepse Maliqi ishte djali dhe fëmija i vetëm i Imerit, ishte më i riu në familjen e tyre dhe nuk kishte shumë kohë që ishte martuar. Të nesërmen në mëngjes, kur xhaxhallarët e tij Selmani dhe Meta, nuk ndosheshin në shtëpi, Maliq Topuzi, mbylli derën e vathës së bagëtive, ledhatoi qenin, i foli dhe i tha diçka atij; ndoshta e porositi të kujdesej për tufën e bagëtive. Edhe qeni, në shenjë mirëkuptimi me të zotin, lëvizte ledhatueshëm kokën, shtriu me përkelechi dy këmbët e përparme dhe në shenjë premtimi se do ta zbatonte porosinë, përkuli trupin dhe tundi bishtin. Pastaj, Maliqi, u përqaftua dhe u përhëndet me prindërit e tij të dashur, babë Imerin dhe nënë Fatimen, por shpejt u shkëput nga krahët e tyre, nga përqaftimi i tyre i ngrohtë dhe i përballshëm dhe u fut midis partizanëve. Pak çaste më vonë, nga mesi i partizanëve, përhëndeti përsëri me dorë prindërit e tij; ndoshta me atë lëvizje dore përhëndeti edhe tufën e bagëtive në vathë, edhe qenin, edhe pemët dhe muret. Pastaj eci përpara, eci lart, kaloi kodrën matanë dhe eci rrugës së malit, rrugëve të maleve, rrugës së gjatë të lirisë. Burrë e grua, Imer e Fatime Topuzi, për një copë kohë, mbetën në oborrin e shtëpisë, ashtu, me sytë nga rruga, drejt kodrës, drejt malit, andej nga u nis e shkoi biri i tyre, Maliqi. Vetëm pas një cope të gjatë kohe, me sytë nga mali, Imer Topuzi kthehet nga e shoqja, Fatimja dhe, në atë përhumbe mendimi dhe shikimi, përpara se të shihnte atë, pa lotin në sytë e saj. Lotë të ngrohtë. Lotë të nxehtë. Lotë nëne. Nuk



i foli dhe nuk i tha asnjë fjalë, por lotëve të saj ju përgjigj me lotë. Të dy, burrë e grua, ashtu në heshtje, u panë gjatë sy më sy, pa folë dhe pa thënë asnjë fjalë. Secili prej tyre, atë çast, kishte nevojë për fjalën e tjetrit, por asnjëri s'e hapi gojën, asnjëri asnjë fjalë s'e tha, por vetëm heshtën. Sa shumë fjalë fshihte ajo heshtje. Ata vetëm heshtën, por nuk folën, sepse, ndoshta, do të kishin kohë për të folë. Do të flisnin gjithë jetën e tyre për këtë ditë, për këtë cast. Dhe ashtu, duke u parë sy më sy, të dyve, u rrodhën lotët. Lotët e të dyve, në oborrin e shtëpisë, mbi një rrasë guri u ranë dhe kurrë, asnjëherë, s'u thanë. Ata heshtën, por foli loti. Ata nuk folën, por foli heshtja. Ajo heshtje foli shumë, ajo heshtje foli gjatë. Akoma, edhe tani, pas kaq shumë vitesh, flet loti dhe heshtja e gjatë e asaj dite të gjatë dhe të nxehtë vere. As derën e vathës së bagëtive nuk e hapën atë pasdite. Harruan ta hapnin. Edhe pse ishin aty, mu pranë tyre, as kumonët, as blegërimat e bagëtive, as leshon e qenit s'e dëgjuan të zotët e shtëpisë. Kishin humbur thellë në ca mendime të trazuara dhe të ngatërruara, secili në mendimet e veta, pa ja thënë dhe pa ja treguar njëri tjetrit. Se malli dhe merak i prindërit për fëmijën e tij peshon shumë. Vetëm prindi e di. Çdo prind e di. Vetëm vonë pasdite, kur në konakun e tyre erdhi Elez Rasha dhe burra të tjerë të fshatit, dy të zotët e shtëpisë, u kujtuan për bagëtitë, që atë pasdite nuk i lëshuan në kullotë. Vetëm atëherë kaluan pragun e derës dhe u futën në kullë. Atë pasdite vere në konakun e Imer Topuzit, dy të zotët e shtëpisë dhe burrat e fshatit, folën e biseduan gjatë. Nuk folën dhe nuk biseduan as për berqetin dhe as për bulmetin, nuk folën e nuk biseduan për punët e hallet e tyre, por gjatë, shumë gjatë, folën e biseduan

për hallet e atdheut, për luftën, për partizanët, për lirinë. Sigurisht, burrat e fshatit nuk i ngushëlluan Imer e Fatime Topuzin, por i uruan për djalin e tyre, Maliqin, që ishte rritur dhe burrëruar dhe që doli partizan.

* **Maliq Topuzi** u lind më 11 tetor 1923, në fshatin Lashkizë të Dibrës. Ishte fëmija i vetëm i Imer dhe Fatime Topuzit (Leka). Ishte djali i urtë, shumë i sjellshëm dhe i dashur dhe shumë punëtor. Bënte të gjitha punët e shtëpisë, me shumë dëshirë, pa bezdi e papërtësë, duke i ndihmuar prindërit e tij, të cilët lumturoheshin kur shihnin djalin e tyre të dashur, tek rritej i shëndetshëm, i shkathët dhe i papërtueshëm, tek e shihnin përkrah tyre, në ara e në stan, në bjeshkë e në mal. Binte gjumë vonë, vetëm kur i kishte mbaruar të gjitha punët e ditës dhe të nesërmen çohëj përsëri herët, për të filluar punët e ditës tjetër. Por një ditë të bukur e të nxehtë vere, Maliq Topuzi, la prindërit e tij të dashur, nënë Fatimen dhe babë Imerin, la arat dhe pemët, la stanin dhe bagëtitë, la rrugët dhe lëndinat dhe doli malit partizan, duke u rrjeshtuar në rradhët e brigadës 4- Sulmuese. Veçse guximtar dhe trim i papërkulur në luftë, përballë armikut, Maliqi, ishte partizan shembullor, i gatshëm në çdo kohë dhe në çdo rast, në çdo sulm dhe aksion luftarak, i dashur me shokët, i kujdesshëm për shokët, për armën, armatimin dhe municionin. Pas luftimesh të ashpëra dhe heroike në fusha dhe male, në fshatra dhe qytete të Shqipërisë, në prag të mbarimit të luftës dhe çlirimit të Shqipërisë, brigada e 4 Sulmuese u ngarkua me misionin e rëndësishëm, asaj ju dha detyra luftarake, që në bashkëpunim dhe bashkëpunim me brigadën e 1 Sulmuese, të

çlironin kryeqytetin, Tiranën. Në ditët e para të nëntorit 1944, harku i rrethimit të kryeqytetit, Tiranës, ishte ngushtuar shumë dhe nazistët gjermanë, të egërsuar në kulm, mbroheshin me të gjitha llojet e armëve. Tirana ishte në çastet finale të çlirimit dhe atë natë, kompania ku ishte Maliqi ishte vendosur në Sauk dhe kishte marrë për detyrë të sulmonte dhe të asgjësonte garnizonin gjerman, i cili ndodhej po në Sauk, në një rreze të shkurtër nga qendra e Tiranës. Garnizoni gjerman ishte i rrethuar në të gjithë perimetrin e tij me gardh me tela me gjemba dhe ruhej me ushtarë nga të gjitha anët. Sipas planit të sulmit të asaj nate, të natës midis 14 dhe 15 nëntorit 1944, në fillim do të minohej garnizoni gjerman pastaj, në çastin kur do të shpërthenin minat, në kulmin e hutimit të ushtarëve gjermanë, kompania do të sulmonte me zjarrin e armëve, për asgjësimin e plotë të garnizonit gjerman. Maliq Topuzi kishte marrë përsipër vullnetarisht, për të minuar garnizonin gjerman. Me të marrë urdhërin për veprim, hidhet përmbi gardhin me tela me gjemba, futet brenda rrethimit të garnizonit gjerman, bën minosjen dhe pastaj tërhiqet për të dalë jashtë rrethimit. Dhe vetëm pak çaste përpara se të shpërthenin minat, në çastin kur ishte hedhur mbi telat me gjemba, për të dalë jashtë rrethimit, një breshëri e gjatë mitralozi i preu hovin. Krisma pushkësh dhe mitralozësh, shpërthime minash dhe granatash. Tym, flakë dhe prush baruti brenda garnizonit gjerman. Dhe atë natë, duke u gdhirë mëngjesi i 15 nëntorit 1944, dy ditë, vetëm dy ditë para çlirimit të Tiranës, Maliq Topuzi mbeti përmbi tela. Gjaku i tij u derdh, aty përmbi tela me gjemba dhe skuqti tokën e përzhitur e të djegur nga flakët e pushkëve, mi-

DOSSIER

i dasmës së lirisë



trolozëve e bombave. Barbaria gjermane, e egërsuar dhe e tmerruar në kulm, të gjithë perimetrin e gardhit me gjemba, e njomën me benzinë dhe i vuri flakën, duke e rivrarë, duke e djegur në flakën e benzinës edhe trupin e përgjakur dhe të pajetë të partizanit të ri djaloshtar, trim dhe guximtar, Maliq Topuzi.

Vetëm pak çaste më përpara se të jepej urdhëri për veprim, Maliq Topuzi, për pak kohë ra në ca kujtime dhe mendime të bukura. Me mendime dhe ëndërrime të ëmbla, i shty ditët përpa-

ra në kohë dhe, e mendoi vendin të çliruar dhe ju bë se liria kishte ardhur. Po e mendonte veten duke u kthyer në fshat fitimtar. Ju bë se dëgjoji zërin e nënës dhe në derën e kullës pa babain, pastaj, shumë shpejt, mendimeve ju ndërroi vend dhe ju bë se dëgjoji zërin e babait dhe në derën e kullës pa nënën. Sa shumë e kishte marrë malli për prindërit e tij të dashur, për përfaqimin e tyre, për buzëqeshjen e ëmbël, për sytë e butë dhe për duart ledhatuese të nënës, për vështrimin, për zërin, brezin dhe

kësulën e babait. E kishte marrë malli edhe për tufën e bagëtive, për pemët, për kroin, për rrugët dhe gurët. Mendimet e bukura, të përzijera me kujtime të ëmbëla e çuan me bagëtinë në Kunorë e në Mafushas, në Kryeshite e në Shpate, te Hurdha e Kalit e në Hurdhat e Maje, në Trojjeza e tek Gurra e Ferexhit. Vetëm Maja e Qelisë ju duk pak më e lartë se më parë. Ndoshta, ajo, Maja e Qelisë, atë ditë që Maliqi shkoi partizan, u zgjat pak më shumë, për të parë përtej kodrave e maleve, ku ecte dhe luftonte Maliqi. Ashtu, i përhumbur dhe i përmalluar, desh t'ja fshihte edhe vetes ca mendime, por s'mundi. Mendoi për nusen e tij të bukur, për përfaqimin e saj të ëmbël, mendoi për shtatin dhe shtratin, për fëmijët që do të lindnin. I harruar në këto mendime të thella, nuk mundi ta pengonte lotin që i njomi sytë dhë faqet. Lot i ngrohtë. Lot i ëmbël. Lot pa kripën e dhembjes, por me mjaltin e shpresës. Këta lotë as nuk i pengoi dot, as nuk i fshihu dha as nuk i pa kur ranë, sepse u dha urdhëri për veprim dhe Maliqi, i la aty, edhe kujtimet, edhe mendimet, edhe lotët, edhe ëndërrat, edhe shpresat, ndërsa vetë fluturoi mbi telat me gjemba. Në ato çaste, kur Maliqi po mendonte për familjen dhe fshatin, mund të ju jenë kryqëzuar mendimet. Sigurisht edhe familja dhe fshati prej shumë kohësh për Maliqin mendonin. Ndoshta, për një çast, vetëm për një çast të vetëm, Imer Topuzi e mendoi veten njëzetë e tre vjet më parë, njëzetë e tre vjet më të ri, kur me Rrahman dhe Elez Rashën luftuan përkrah Misim Ahmetit në Maje të Karmës, në Qafë Gëlqere, në Kodrën e Soricës. Atëherë lufta zgjati shumë, por Imer Topuzi nuk mendoi gjatë për atë luftë, për rininë e tij, sepse mendimet e çuan tek i biri, Maliqi, te lufta që po bënte ai. Kushedi ku është tani?! Kushedi ku p, o lufton?! Të gjithë në familje,



Mbi Lashkizë ka ra ylberi

(Kushtuar dëshmorit Maliq Topuzi)

Sillet shqipja përreth Qelisë,
Kujt i th'rrret sonte n'Lashkizë,
Kujt ja çon lajmin e zisë?
Të gjitha kullat i hapën portat,
Pa ngranë bukë u çuan sofrat,
Kë vajtojnë nënat e motrat?

Imer Topuzit shqipja i flet:
Qëndro burrë e ban gajret,
Se Maliqi në luftë t' ka mbet.
Nuk dha shqipja tjetër xhevap,
Vec tha: ndoshta do t'vij prapë,
Se liria nuk vjen pa gjak.

U shtri nana n'hasrën me kashtë,
Lotë e fjalë ju përzien bashkë,
S'ka takat as me dal jashtë.
Don Imeri t'mbahet i fortë,
Po s'po mundet, qënka e kotë,
I janë mbush grushtat me lotë.

Lajmi i zi i nxiu kullat,
Nanës e babës ju shtuan rrudhat,
Me lotë fshati i mbushi hurdhat.
Në Sauk, në tym dhe n'flakë,
Përmbi tela, gjithë plagë e gjak,
Maliq Topuzi - flamur bajrak.

Nanë e babë n'ujdi kanë ra,
T'bëjnë gajret e mos me qa,
Se Maliqi dëshmor ka ra,
Sa shkoi shqipja dhe erdh haberi,
Sa shkoi nata e dita çeli,
Mbi Lashkizë ka ra ylberi.

Kur ylberi n'Kunorë ka ra,
Arra e mana n'Lashkizë janë tha
Çiftili për këngë janë ba.
Maliq Topuzi s' erdh ma n' Lashkizë,
Veç vjen shqipja përreth Qelisë,
Dhe ja prek telat çiftelisë.
SHAQIR ÇERPJA

ato çaste, të përhumbur në mendimet midis merakut dhe shpresës, ju duk se e panë Maliqin duke u kthyer fitimtar nga lufta, duke ardhur. I qeshur dhe i gëzuar, si lëndinë e bleruar në pranverë, si Livadhet e Bardha në maj, mbuluar me lulezonja, krenar dhe kryelartë si Maja e Qelisë, i ashpër dhe i sertë i Guri i Bletës, shpatullgjërë si bjeshka,...Këto po mendonin njerëzit e tij në fshat, ndërsa në Tiranë, djali i tyre Maliqi përmbi tela me gjemba, në flake, trupi i tij gjithë plagë e gjak, mbeti lapidar, ylber, flamur, bajrak. Aty, përmbi tela me gjemba ishte edhe dasma e tij dhe ai, përmbi tela me gjemba - dhëndërr në dasmën e lirisë... Maliq Topuzi nuk la fëmijë, sepse nazistët gjermanë nuk vranë vetëm Maliqin, por edhe fëmijët e ëndërrave të tij. Por, edhe tani pas kaq shumë vitesh, më shumë se shatatë dekadash, ai nderohet nga fëmijë e të rritur. Shkolla 9- vjeçare në vendlindjen e tij, në Lashkizë, mban emrin e tij. Një lapidar, po në vendlindjen e tij, në qendër të Zall Dardhës dhe një tjetër lapidar tek Kthesa e Kamzës, ngjitur me portën kryesorë të kompleksit malezian të banimit në pllakat e mermerta, të gdhendur kanë emrin e Maliq Topuzit, dëshmorit të atdheut, ylberit që harkon mbi shekujt dhe historinë, birit të nderuar të Lashkizës e Zall Dardhës, Maliq Topuzit- dhëndërr në dasmën e lirisë...

STUDIMI

Zadrina vetqeveriset si një republikë një autonomi që ua kalon edhe maleve (1503 – 1759)

Zadrina (Tejdrina) e vetëqeverisur

Nga XHEMAL MEÇI*

Udhëtarë të huaj, relatorë e humltues, studiues e historianë kanë shkruar për bukurinë e begatinë, autonominë e qeverisjen e Zadrime:

Marin BARLETI, humanist e historian i fillimshkullit XVI: Zadrina është "një fushë pjellore dhe tërë shëndet, e pasur me gjuhë e plotë me bletë e me gjithfarë prodhimesh e pemësh... Shkrimtarët e vjetër u kanë thurur këtyre vendeve lavde me një sedër të tillë, sa që duket zor t'u ketë mbetur vend pasardhësve për t'u thënë ndonjë gjë tjetër."

Frang BARDHI, prëlatkrishtar, por edhe shkrimtar e historian, leksikograf dhe etnolog i fillimshkullit XVII: Zadrina është në "një fushë shumë të bukur... me ara shumë të plëshme dhe të begatshme me çdo fryt... kafshë me shumicë... kroje shumë të ftohta... ka lumenj me çdo lloj peshqish... Ajrin e ka shumë të shëndoshë e ma në fund ashtu krejt e ganishme (e qenme) me çdo send që t'i nevojitet jetës njerëzore..."

Evlija ÇELEBIU, diplomat e funksionar i Portë së Lartë, udhëpërshkrues e historian turk i shek. XVII: në Zadrinë "njerëzit duken shumë të gjallë nga fizionomia dhe pamja e jashtme, për shkak të klimës së fortë... në lumin e këtij qyteti (në Dri, Dejë) del shumë peshk i cili eksportohet në Francë... Peshku, rrushi, pemët e boshtanët e këtij vendi janë me emen".

ZADRINA, SHTRIRJA DHE KUFIJTË

Zadrina (Tejdrina) është një krahinë fushore e bukur e pjellore në Ul-tësirën e Nënshkodrës. Fusha është e sheshtë dhe e ulët, me rreth 20-25 m mbi det. Mesi i saj përshkohet prej kodrinash me lartësi të vogël, 80-100 m ku janë ndërtuar kisha dhe vendbanime për t'iu shmangë përmblytjeve të Drinit. Klima është e butë, mesdhetare, fushore. Dimrit Drini sjell erëra të ftohta, murla, që shkakton edhe ngrica. Sasia vjetore e reshjeve është mbi 400 mm (Fjalori enciklopedik shqiptar. Tiranë, 1985). Zadrina përfshinë fshatrat: Baqel, Blinisht, Dajç, Dragushë, Fishtë, Gramsh, Gjadër, Kallmet, Kodhel, Kotërr, Krajin, Mabë, Mërqij, Piraj,, Rraboshtë, Troshan, Zoja) që i përkasin Lezhës; Qendrat: Vadejs, Hajmel, Kaçë, Mjedë, Naraç, Paçram, Pistull, Plezhë, Shelqet, Shkëzë, i përkasin rrethit të Shkodrës, Bashkia, Laç; (F.E.SH., Tiranë. 2009, f.2968).

Kufiri natyror V, VP deri JP është lumi i Gomsiqës e Drini. J e JL kufi janë Balldri (Balldre) e Kallmet. JL është mali i Velës, kurse L e mali i Hamelit.

Fr. BARDHIë përkufizon rrethin e Zadrime në "afro 70 mil në fushën përballë lumit të Drinit" dhe në Jug të Gomsiqës. Edhe albanologu Han, afro 200 vjet mbas Fr. Bardhit, brenda kufirit verior përfshin edhe Zadejën, në jug të Gomsiqës.

Studiuesi zadrimer P. GJONI duke parë Zadrime në vështrimin etnologjik, shprehet për kufij më të gjërë: deri

te bregu i majtë i Kirit (VP) dhe Karriqi (JP). Zadrina (Tejdrina) ka të veçantat e veta etnografike e që pasqyrohen në veshën e bukur të grave Zadrimore, veshë me pëlhura me qëndisima plot figura e ngjyra të gjalla. Edhe veshja e burrave ka të veçantat e veta në përshatje me klimën fushore.

Sadoqë ka pasë ardhës të herëpashërshëm prej maleve, pra për ka vazhduar të jetë një krahinë unike etnografike, sepse ardhësit mbas do kohe janë integruar (unisuar) në veshje, në doke, në rite e të folme me vendasit (anasit). Këto tregues, që ende janë të pranishëm, dëshmojnë se Zadrina (Tejdrina) gjithmonë ka pasë banorë me traditat e veta etnokulturore, të trashëguara në shekuj. Për një unitet kulturor, shoqëror, ekonomik, politik dhe kishtar, që ka vazhduar deri në shek. XIX shprehet edhe Fr. Bardhi, i cili e gjenë të qëndrueshëm në fillimshkullit XVII, bile të shtrirë deri afër qyteteve të Shkodrës.

EMRI I ZADRIMËS -FUSHA TEJDRINIT

Është një toponim me ndikim sllav, një përkthim në sllavisht i fushës së përtej Drinit, Përtejdrina / Tejdrina, Fusha e tejdrinit, e parë prej qytetit të Shkodrës. Pra emri i saj ka qenë krejt



shqip: Përtejdrina / Tejdrina. Këtë emërtim për emër visi e gjejmë edhe në Pukë e Tropojë. Puka anës së andejshme të brigjeve të Tropojës, në të djathtë të Drinit i quan Përtejdrina. Po kështu ana e brigjeve të Tropojës: brigjet në të majtë të Drinit (të Pukës) i quan: Përtejdrina, Pertedrin. Nikaj – Mërturi për Apripën e Gurit thot – Tejuj "Jam prej tejuj".

Prof. dr. David Luka, lidhur me toponimet me burim sllav shpjegon: "Shumica e emrave me burim sllav... janë përkthime nga shqipja në sllavisht." (D. Luka, Studime gjuhësore. Shkodër, VI / 2001).


Edhe prof. E. Çabej pohon për këto huazime se "Drin, Vjosë etj., i përkasin shtresës para sllave të vendit." (E. Çabej, Studime gjuhësore. Prishtinë, III/1976).

Edhe FESH(Tiranë,209, f. 2989.)

kështu e shpjegon Zadrimeën (Zadrina, Fusha e Tejdrinit).

Emrat; Zadrime e Zadejë tërëqenë edhe vëmendjen e Hanit. Zadejën e shpjegon me Za/Tej: Zadeja / Tejdeja. Për shpjegimin e emrit Zadrina ndalet më shumë, duke nënvizuar faktin se – za "në sllavisht ka pikërisht kuptimin – përtej." Pra, Zadrime "domethënë përtej Drimi-t, për shkak se sllavishtvishtja –n –në e saj e shndërron në –m (J. G. Von Hahn, Udhëtim nëpër viset e Drinit... botuar 1867, përkthyer e botuar nga Ger e N. Lleshi. Tiranë, 2001). I këtij mendimi është edhe albanologu Th. Ippen, konsulli Austro – Hungarez në Shkodër më 1884-1902, Zadrina që ka kuptimin "përtej Drinit apo Drim-it, ajo e ruan që nga koha, kur Shkodra ndodhej nën sundimin serb ashtu si edhe Ulqini dhe rajoni i tij thirrreshin nga ky vend (Shkodra) – Zabojana / Përtejebuna." (Th. Ippen, Shqipëria e vjetër. Tiranë, 2002.)

Në përfundim, emri i parë i Zadrimeës ka qenë krejt Shqip: Tejdrimi, / Tejdrina, si rrjedhojë e pozicionit gjeografik të saj, e parë prej kështjellës së Shkodrës, ashtu si edhe Përtejebuna / Tejbuna. Gjatë pushtimeve sllave u përshtatën në gjuhën e tyre në trajtën: Zadrina, Zadeja, Zabojana etj. trajta sllave, e përdorur për shumë kohë në administratë, duke ia detyruar edhe



si një republikë."

Burimet arkivore dhe ato të botuara zbardhin faktin e rëndësishëm se Zadrina (Fusha Tejdrini) është një krahinë fushore me autonomi vendore (vetqeverisjeje), që përbën një nga rastet e rralla apo krejt të veçanta për krahina e zona fushore, në kuadrin e sundimit osmanë Shqipëri. Prandaj, ka shumë rëndësi të vërtetohet se si u fitua autonomia krahinore, si u mbrojti dhe si vazhdoi deri në fillim të shek. XIX, kur u përfshi në Pashallekun e Shkodrës, 1759. Megjithatë edhe Bushatlitë për të ruajturë mardhënie të mira me viset e krishtera ua la në përgjithësi mjaft tradita vetvetqeverisjeje.

SI U ARRIT DHE SI U MBROJT KJO VETQEVERISJE

Kjo autonomi (vetqeverisjeje) që vazhdoi para më se dy shekuj (1503-1759) dhe lidhet,

së pari, me princin Prigon Dukagjini. Ky, kur pa se kryengritja e vitit 1501 – 1503 përfundoi pa sukses, nuk u kthye më në Itali, por bëri marrëveshje me SANXHAKBEUN E SHKODR Feriz Beun, qeveritarë i rëndësishëm osman që ta lejonin të vendosej në Zadrime, duke njohur varësinë e Sulltanit ndaj pushtetit të vet. Marrëveshja u arrit. "U pranua vetëm kërkesa e Prigon Dukagjinit, të cilit iu dha titulli i pashës (i gjeneralit) dhe, në formë timari (të ardhura vjetor deri në 20.000 akre në vit mbi një pronësi të madhe tokash e 33fshatrash) "një pjesë e zotërimeve të Dukagjinëve." (H. P. Sh. Tiranë, 1/2002, f. 478). Prigon Dukagjini apo ndonjë trashëgimtar i tij siguruan marrëveshjen me qeveritarët turq që Zadrina të ishte në vartësi të Sulltanit duke i dhënë një detyrim vjetor "shumë më pak tribut se atë që paguanin viset" e tjera fushore. (Fr. Bardhi, Relac. 1641). Le të shohim se çfarë relaton më 27 mars 1638 fra Kerubini, titullari i klerikëve misionarë Italian, Zadrime. "Zadrina ka shumë përjash-time (detyrimesh) nga Sulltanit, sepse që një zotni po prej Zadrime... (Të cilit

VETËQEVERISJA E ZADRIMËS (TEJDRINËS)

Fr. Bardhi është relatori kryesor, që dëshmon faktin se Zadrina "Qeveriset

STUDIMI

për më se dy shekuj

kur i erdh vdekja në Stamboll (i kërkoi) Sulltanit: "Dua që të më falish Zadrinën, që më ka nderue kaq shumë, dhe prandaj due që të jetë e lirë nga sanxhakbejerët, nga spahijtë, nga pashallarët etj, të ketë vetëm një kadi (gjyqtar) që të bajë gjyq dhe një xhabi (tagrambledhës e administrator civil i Zadrinës), të zgjedhur prej tyne dhe jo tjetër." Kjo kërkesë del të jetë pranuar prej Sulltanit, sepse Zadrinorët "janë shumë ma të lirë se të tjerët." (Fra Kerubino).

Fr. Bardhi, tre vjet më vonë, në Relac. e vitit 1641, pohon po këtë fakt me disa plotësime: "Pashë Dukagjinin... kohën e Sulltan Sulejmanit... (i kërkoi) që t'ia falte Zadrinën... me detyrimin që të ndreqte (mirëmbante) 30 ura përmbi lumejtë e Zadrinës,... por me urdhër të atij Perandori (Sulltani) që duhej që të mos u nënshtrohej spahijve... në timarë, si edhe për të mos qenë të shtypur nga sanxhakbejerët, xhabijtë, kadilerët, vojvodët... por (Zadrinën) të jetë drejtëpërdrejt e nënshtroeme ndaj Perandorit me një trubut që shkonte për nevoja të një spitali në Stamboll, i cili ish nën kujdesin e vet Sulltanit me anë të xhabisë, që e emnonte vet Ai. Pra, duhej ta emonte vet ai vjet për vjet, me të shumtën atë që duan Zadrinorët, dhe të paguanjë shumë më pak tribut se atë që paguejn viset e tjera fushore." Në emrim kishte edhe ndëhyrje me para për emërimin e atij që kishte interes për atë postë. Me një fjalëkëto veprime nuk i kishin shpëtuar korrupsionit. Po kështu ehe posti i Kadit.

Zadrinorët për nevoja politike të Qeveritarëve Osmanë për të qetësuar krahinën e madh e të pasur të Zadrinës, e cila ishte mbështetje e fuqishme e maleve të panënshtuar që krynin sulme të fuqishme drejt Lezhës e bregdetit të saj.

Sa herë që Zadrinorëve u çenohej ky statut prej ndonjë beu a sanxhakbeu Zadrinorët merrnin masa mbrojtëse qoftë edhe me armë, qoftë edhe deri duke iu ankuar vetë Sulltanit nëpërmjet një përfaqësie të tyre, që e merrnin përsipër këtë barrë të rëndë duke rrugëtuar për Stamboll.

Për rastin e vitit 1610, kur sanxhakbeu i Shkodrës sulmoi Zadrinën,

kemi Relac. M. Bicit, prelat e lartë i kishës katolike, arqipeshkvi i Tivarit. Ai relatoi një sulm të egër, me shpatë e zjarr duke djegur shtëpi e grabitur gjëra me vlerë, si edhe kope të mëdha bagëtishë. Këto veprime të rënda i shfaqësoi, duke thënë se ishin ndëshkim për pengesat që u kishin bërë Zadrinorët një vit më parë forcave të tij që po dërgoheshin simbas urdhërave të Portës së Lartë për ndëshkimin e viseve të Dukagjinit (Pukës). Ishte e vërtetë se Zadrinorët e kishin kryer një pengim të tillë, po këtë e shihnin si një tagër të mbrojtjes së tyre, Ssepse Zadrinën bashkë me Shëngjirin, Lezhën e viset e Pukës varehin prej sanxhakbeut të Dukagjinit.

Për më tepër, Zadrinën kishte lidhje të ngushta demografike, ekonomike, shoqërore e kishtarë me viset e Pukës, që kundërshtonin gjithnjë së bashku sundimin osman.

Ja si e përshkruan M. Bici këtë rezistencë të zadrinorëve të vitit 1610: "sanxhakbeu i shkorës kishte kalue Drinin dhe kishte hy në fushën e Mjedës... Ky kishte mbledhë për luftë të gjithë myslimanët e të krishtenët që varehin prej tij që nga Tivari, Ulqini, Trushi, Kakarriqi, Kukli, si edhe ata që rrinin në brigjet e Bunës... Zadrinorët bajnë kuvend para se të ndizej zjarrin (i luftës). Dërguan "disa pleq kryesor të tyre" me dhuratat për ta zbutur sanxhakbeun me shpresë se do të tërhiqej. Edhe pse ai mori dhuratat, nuk u tërhoq. Përkundrazi, priste ardhjen e forcave të Isuf Beut, që të sulmonte në befasi. "Kur Zadrinorët e panë këtë, u bashkuan nën komandën e Saferit, prefektit (zëvendësit) të xhabisë.

Edhe Ferat Kotus aga (mysliman duke qenë... u paraqitë përballë lamës së sanxhakbeut... dhe përlëshja u ndez. Në hovin e parë... mbetën të vdekun e shumë të plagosun, sidomos në anën e Zadrinorëve... (që) kishin vetëm ndihmën e leshjanëve, filluan të sprapseshin... megjithëqë Saferi, i cili ishte një djalë rreth 22 vjeç, shumë guximtar, ishte vendos para të gjithëve dhe për një kohë të gjatë e përmbajti hovin e anmiqve... luftimi i asaj dite mbaroi... pasi Hajmeli, Ranëz dhe fshatrat e tjera për rreth qenë plaçkitë të gjitha, deri te shtëpitë e xhabisë,

të cilat ranë të gjitha plaçkë në dorën e anmiqve pa kursye asnjë shtëpi... shtëpive u qe vu zjarr aq sa... shiheshin nga Kakarriqi e nga fshatrat e tjera të rrethit (rrethinave) flakët tue u naltue deri në qiell... zadrinorëve u desh të vendosnin të jepnin një shumë të madhe të hollash, me të cilat pas shumë përpjekjesh, i zbutën anmiqt, e çdo gja u qetësue." M. BICI, Relacioni i vitit 1910. "RELACIONE T, 1963 f.)

Përveç përpjekjeve me armë për vetëmbrojtje prej grabitjeve, dhunës e keqtrajtimeve të tjera prej armiqve të tyre që kishin lidhje me pushtetarë të rëndësishëm lokal turq (në shërbim të turqve ankoheshin në Stamboll, ku sigurinon urdhëresa, që kërkonin respektimin e statusit të Zadrinës. Për këtë kemi dëshminë e Fr. Bardhit, relac. i vitit 1641, ku vërteton se Zadrinorët sigurinon "nënshkrime (prej) dorës së perandorëve turq, d.m.th. së pari (prej) Sulltan Sulejmanit (1523), pastaj të pasardhësve të tij: Selimit, Bajazitit, Muratit III, Osmanit, Mustafajit, Muratit IV dhe Sulltanit të sotëm, Ibrahimit."

Sigurisht, dekrete të tilla ndëshkuese shoqëroheshin edhe me ndëshkime ndaj atyre që shkelnin e dhunonin Zadrinën me vetëqeverisjen e saj lokale, gjë që del qartë nga relacioni në fjalë, ku nënvizohet fakti se ato dekrete dilnin prej "vetë dorës së perandorëve turq" (Sulltanit). Prandaj, rasti i 1610-s, Sanxhakbeut të Shkodrës, Ali Kasapanit, në bashkëpunim me ish-sanxhakbeun (para tij), Isuf beun, me mobilizimin e të gjithë varësve të tij që nga Tivari, duke u marrë vesh edhe me sanxhakbeun e Dukagjinit, të cilit i përkiste Zadrinën, tregon se si donte të bashkëfajësonte kaq shumë pushtetarë të rëndësishëm me qëllim që të justifikoheshin për aktet e kryera kundër Zadrinës, në mënyrë që të merrte një ndëshkim sa më të butë, në se nuk mund të shmangej ajo masë ndëshkimore.

MËNYRA E VETQEVERISJES SË ZADRIMËS, STATUSI,

Dëshmia kryesore për vetëqeverisjen e Zadrinës është ajo e Fr. Bardhit, relac. 1641. Simbas të dhënave të kësaj dëshmie Zadrinën përbëhej prej 30 fshatrash me rreth 1000 shtëpi, me mbi 12000 banorë. Të krishterë: 864 shtëpi me 11.400 frymë; myslimanë ("turq", siç quhen me urrejtje prej rrethorëve), rreth 150 shtëpi me afro 1000 frymë. Myslimanët ishin të shpërndarë nëpër fshatra, ku më pak e ku më shumë. Më shumë kishte në Mjedë. Në Blinisht asnjë.

Simbas prof. Selami PULAHA, një gjysëm shek. më parë (fundshek. VI) Zadrinën kishte 575 shtëpi në 23 fshatra. Krahasuar me regjistrat e vitit 1529-'36, kur Zadrinën shënohej me 22 fshatra e vetëm 231 shtëpi, tregon se në fillimshk. XVI, fshatrat kishin rënë mesatarisht në rreth 10 shtëpi për fshat.

Me statusin e fituar, rritet siguria dhe, për rrjedhojë, edhe ripopullimi i shpejtë i Zadrinës. Për afro 70 vjetë të



Kostumi i Zadrinës, nga Piktori Simon Rrota

shek. XVI numri i shtëpive në Zadrinë rritet gati me dyfishin (nga 231 shtëpi në 575). Në vazhdim, për më pak se një gjysëmshkulli, përsëri numri i shtëpive i afrohet dyfishit (nga 575 në rreth 1000 shtëpi). Pakësimi i fshatrave e i shtëpive në fillimet e shek. XVI P. Gjoka e lidh me largimin në male për më se siguri.

NJËSITË PËRBËRËSE TË ZADRIMËS SË VETQEVERISUR

Zadrinën ishte e ndarë në 8 njësi kishtarë (8famuli), megjithëse, si Fr. Bardhi, si fra Kerubini, gjithnjë përmendnin 9 famulli. Po famullia e nëntë që Sarda e cila nuk që Zadrinë, por i qe bashkuar Ipehshkisë së Nënshatit. Famullia kishte një ose më shumë priftërinj, por njëri ishte famullitari, që drejtonte famullinë. Famullia përbëhej prej një fshati, si Nënshati e Shkjezi; prej dy a më shumë fshatrash, si Blinishti e Hajmeli, etj.

Skema e njërive famullitare ishte ndërtuar si vijon:

1. Nënshati: 180 shtëpi, 1800 frymë, kisha e shën Gjergjit;
2. Troshan me Fishtë: 70 shtëpi, 700 frymë, kisha e shën Mërisë;
3. Blinisht me Gjadër: 220 shtëpi, 2300 frymë, kisha e shën Shtjefnit;
4. Krythi, Dajçi, Kotrri e Kade-li: 93 shtëpi, 800 frymë, kisha e shën Demetrit;
5. Baba, Zojzi, Gramshi, Dragusha, Paçrami: 85 shtëpi, më se 1000 frymë, kisha e shën Pantaleut, (Meshtar abati dom N. Leka);
6. Shkjezi, 20 shtëpi, 250 frymë, kisha e shën Gjonit;
7. Mjeda, Spathari, Zadeja, Shëldia, Lisna, Laçi e Lumasi (Lumasi herë si fshat e herë si lagje e Mjedës), 100 shtëpi, 700 frymë, kisha e shën Mërisë (Dejë);
8. Hajmeli, Ranesi e Naraçi: 66 shtëpi, 490 frymë, kisha shën Mëria e Galinës. (Nga kjo radhitje famullishë e fshatrash, dalin 25 fshatra e jo 30 siç i jep në shifër të rrumbullakosur relac. 1641).

Në shekujt e mëvonshëm del që këto famulli të jenë shtuar në 11, të cilat Gegë Miloti i shënon me këtë renditje: 1. Dajçi, 2. Gramshi, 3. Maba, 4. Pistulli, 5. Laçi, 6. Naraçi, 7. Hajmeli, 8. Nënshati, 9. Troshani, 10. Blinishti, 11. Gjadri. (Gegë Miloti, Dioçezi i Sapës, Famullia e Dajçit. Shkodër, 1999, fq. 7).

(Vijon nr e ardhshëm)

*Studjues – Mjeshtër i Madh



PROFIL

Gruaja nga Durrësi, simbol të mençurisë dhe identitetit njerëzor në Italinë fqinje

Fatime Kërçuku –kariera universitare e gruas ambicioze

Halil RAMA

Megjithëse e ëndërronte dhe e dëshironte karrierën universitare, për Fatime Kërçukun, në rininë e saj të herëshme, kjo dukej e pamundur. Kjo edhe për faktin se prindërit e vajzës së lindur dhe rritur në qytetin e Durrësit, ndonëse ishin arsindashës i përkisnin klasës punëtore. Gjithsesi Fatimeja, kur sapo kishte mbaruar 8-vjeçaren në shkollën “Kristaq Boshnjaku” ndjente keqardhje për pamundësinë për të vazhduar gjimnazin. Në moshën më të bukur të adoleshencës ajo i lutej Zotit dhe shpresonte që t’i krijohet mundësia për të vazhduar shkollën. Madje, jo vetëm gjimnazin por edhe universitetin.

Martohet kur ishte vetëm 18 vjeçe dhe më pas fillon punë nëfabrikën e miellit në Durrës. Megjithë vështirësitë e të qenit bashkëshorte dhe njëherazi punëtore, etja për të zgjeruar dijet dhe për të qenë sa më e denjë në profesionin që kishte zgjedhur e inkurajon për t’u interesuar se ç’shollë duhej të ndiqte. Pa ngurim regjistrohet në Teknologjikën Ushqimorë të Durrësit. Me një zell të paparë, ditën punonte dhe në mbremje vijonte mësimet, pa shkëputje nga puna.

Për kohën ajo u bë simbol i femrës shqiptare që po ecte me dinjitet në rrugën e vëshirë të dijes. Kësisoj, me synimin për t’u bërë teknologe shembullore, ndonëse nënë me dy fëmijë të vegjël (dy djem, 15 dhe dy muajsh) nuk u shkëput nga shkolla.

Me eksodin e parë në mars të vitit 1991, bashkëshorti i saj u largua për nëItalinë fqinje për një jetë më të mirë, për vehte dhe për familjen. Në këto kushte, ishte e natyrshme që jeta e Fatimes me dy fëmijë të vegjël të komplikohet disi. Ndërsa punonte nëfabrikën e miellit, arriti me këmbëngulje deri në vitin e katërt të shkollës...dhe më tej e pati të pamundur. Por ndonëse u duk se iu ndërpre ëndërra ajo nuk u demoralizua. Mbas disa vitesh, regjistrohet sërisht nëshkollën e mesme të përgjithshme “Olsi Lasko” në Durrës. Arriti të konvertojë disa lëndë dhe të nisë gjimnazin nga viti i dytë, derisa e përfundon me rezultate inkurajuese.

Tashmë kur kanë kaluar tre dekada nga jo kohë, Fatimeja i kujton me nostalgji vitet kur ndiqte teknologjikën, por dhe ato të gjimnazit.

Kur kishte arritur pjekurinë maksimale dhe ishte e gatshme të përballonte vështirësitë e kohës, për këtë zonjë simbol të mençurisë dhe identitetit njerëzor, krijohen kushte të reja për të vijuar denjesisht udhët e jetës.

Ishte viti 2000 kur pasi kishte bërë bashkim familjar nisët për në Itali.

“Ditën e dytë të qëndrimit në Itali, sëbashku me bashkëshortin shkuam të regjistrojmë fëmijët në shkollë. Ndërkohë që po bisedonim me Drejtoreshën e kësaj shkolle, i them bashkëshortit, që të pyeste Drejtoreshën se ku kishte shkollë apo kurse për mua. Doja të mësoja gjuhën italiane në radhë të parë që të mund të komunikoj me autoritetet në shtetin fqinj...”,-shprehet Fatimeja. Dhe ndërsa kujton atë ditë të shënuar në jetën e saj, kjo grua fusnike flet me admirim për drejtoreshën, duke e përshkruar atë si një zonjë fantastike,



Foto e Dites se Diplomimit ne Economi Amministrazione dell'Impresa, momenti ne te cilen marr urime te perzemerta nga Kryetaria dhe te gjithë Anetarët e Komisionit te Diplomave.

e cila i vuri në dispozicion një mësuese për tadërguar tek shkolla ku bëheshin kurse në gjuhën italiane për të huajt. Në atë shkollë, pasi kaloi me sukses testin e parë, e regjistruan menjëherë. Ndonëse ishte një kurs me dy ditë në javë dhe orë të kufizuara, Fatimen e ndihmuan shumë, të paktën për të komunikuar, sepse ishte domosdoshmëri. Në fund të vitit u bë një test ku ajo arriti të fitonte të gjitha pikët e mundshme (100/100). Dhe ky ishte vërtetë gëzim i madh. Fatime Kërçuku, me virtytet e një zonje të përkryer në çdo aspekt u inkurajua shumë nga ky vlerësim.

Kur kishte kaluar vetëm dy vite me bashkëshortin dhe dy djemtë në Itali, në vitin 2002 regjistrohet në gjimnazin e Ragionerie Vittorio Manuele, Bergamo. Edhe këtu impenjimi i saj ishte tepër i madh, gjithashtu ndjente edhe kënaqësi.

Në përfundim të vitit të parë të gjimnazit, papritur e thërret Nëndrejtori i shkollës, Z.Demetrio Polimeno në zyrën e tij. Ndjeu ankth dhe pothuajse u terrorizua nga kjo e papritur, kur po mendonte me vehte se ç’mund të kishte bërë që thirrej e vetme nga numri dy i shkollës. Por kjo ndjenjë disi e frikshme kaloi shpejt. Nëndrejtori e pret në zyrë me një respekt të madh. Shkurtimeisht ai i thotë Fatimes se duke parë rezultatet dhe angazhimin në shkollë, bagazhin jetësor dhe përgatitjen e saj, autoritetet po i krijonin mundësinë të vazhdonin studimet në universitet. Të njejtin vlerësim kishin shprehur edhe pedagogët të tjerë në mbledhjen e organizuar për këtë rast të veçantë.

Moment vërtetë mbresëlënës ky, për Fatime Kërçukun, e cila pas vështirësish të panumërta po bënte realitet ëndërrën për të vijuar karrierën universitare. Kjo, pasi autoritetet e gjimnazit tëRagionerie Vittorio Manuele, Bergamo e vlerësuan edhe zyrtarisht me “Riconoscimento di Merito”(“fletë lavdërimi”).

“Nuk mund të arrij të shpreh se ç’farë emocionesh provoja. Ishte e pa besueshme! Akomasot nuk e besoj, por është fakt. Ndaj dhe e falenderoj pafundësisht nëndrejtorin Demetrio Polimeno dhe gjithë pedagogët e shkollës Vittorio Manuele di Bergamo, që jo vetëm vlerëuan përgatitjen dhe nivelin e dijeve që kisha përfutur, por më dhanë

dhe forcë për të përballuar sfidën e universitetit”, -pohon Fatimeja.

Në vitin 2003 u regjistrua nëUniversitë degli Studi di Bergamo Facoltà Economia. Nuk e kishte shumë të lehtë sepse, ishte nënë e dy fëmijëve dhe i duhej të ndiqte hap pas hapi jetën e tyre,shkollimin e tyre.... Filloi të ndjekë mësimet dhe si pa e kuptuar iu komplikua sërisht jeta. Me shumë punë e përkushtim arriti të përvetësojë gjuhën italiane që ishte e domosdoshme për të kuptuar dhe përvetësuar terma ekonomike.

I dukej veltja si në botën e çudirave kur pedagogët e profesorët e universitetit jepnin leksione pambarim. Studentja shqiptare, ndonëse kishte vështirësi në të kuptuar, shkruante, përvetësonte dhe perceptonte ato që merrte nga leksionet, me dëshirën e madhe për të realizuar ëndërrën e saj.

Nëfund të vitit të parë të universitetit mori dy provime: Ekonominë Aziendale me notën 24/30 dhe informatikën me notën 23/30. “Ç’farë gezimi! Nuk ishin nota ecellente por as për të mos u vlerësuar, pasi kishte studentë shqiptarë në kursin e saj që sapo kishin dalë nga bankat e shkollës dhe nuk kishin mundur të merrnin këto rezultate. (Merrnin 18/30 dhe ishin të kënaqur, sepse ndjekja e mësimëve në gjuhën e huaj nuk ishte e lehtë as për këta studentë). Fatimen e inkurajuan pa masë vlerësimet në këto dy provime...dhe më pas dha provimin e gjuhës angleze me shkrim ku u vlerësua me notën 25/30.

Ndonëse i pëlqejnë, ajo e pranonte edhe vetë që nuk është shumë e dhënë pas gjuhëve të huaja. Gjithsesi kur iu nënshtrua provimit të anglishtes me gojë Profetori anglez Z.Brian Pritchard u mahnit me nivelin e përgatitjes së saj. “Komplimente! Ti je shembulli i shqiptarëve”, u shpreh Prof. Brian Pritchard. Dhe janë të kuptueshme ndjenjat e gëzimit të veçantë që ndjen një student pas vlerësimeve të tilla nga profesorë me emër.

Duke vazhduar karrierën universitare, Fatimes iu krijua mundësia të bënte dhe stazhin tek UBI Insurance Broker, Bergamo (Tirocinante presso ufficio fidi e crediti (promosso dall’Università degli Studi di Bergamo). Që në colozhim/intervistën e parë shefi i kesaj

Banke firmosi menjëherë kontratën për praninë e saj në atë zyrë ku kanë respektuar dhe vlerësuar sikur të njiheshin prej kohësh.

Mirënjohja është shprehja më e bukur e karakterit të njeriut. Këtë, më shumë se askush tjetër e ka rrënjësuar në mendje Fatime Kërçuku, e cila në mbyllje të stazhit i dërgon këtij grupi një mesazh falenderimi, ku specifikon: “In UBI Banca, ogni singola persona è preziosa. Fanno entrare nel loro squadra e collaborare, con le sue idee, a raggiungere traguardi sempre più ambiziosi.”. Këtë mesazh ia xhiruan çdo zyrtari në atë Bankë. Për Fatimen ky ishte një falenderim i merituar, ndaj dhe gjen rastin t’infalenderojë.

Në karrierën universitare Fatimja është përplatur me shumë vështirësi, por edhe ka sakrifikuar shumë. Me ambicion për të arritur synimin që i kishte vënë vehtes tregoi angazhim maksimal në funksion të karrierës universitare.

Me këtëimpenjimin arriti të përfundonte



jë të gjitha provimet. Dhe më pas nis të përgatisë Testin/Temën me një nga Profesorët më të mirë dhe më kërkuesit këtij universiteti. Relatorin e saj,Prof. Domenico Piattiku e falenderon pafundësisht për nivelin profesional, bagazhin, mirësjelljen dhe besimin që tregoi ndaj saj.

Kurajoje dhe kërkese ndaj vehtes, falë përgatitjes ideoshkencore, Fatimja arrin të mbrojë me dinjitet temën dhe të vlerësohet me të gjitha pikët e mundshme nga komisioni, i cili i dha i asaj titullin “Dottoressa In Economia e Amministrazione dell’Impresa”. Ndërkohë Fatimja vazhdon Magistralen/Masterin në direzionen MANAGEMENT, FINANZA E INTERNATIONAL BUSINESS.

E plotësuar tashmë si intelektuale e zonja, me karrierë të lakmueshme universitare, Fatime Kërçuku falenderon përzemërsisht prof.ssa L. Viganò, L.Gibilaro, Prof. P. Ferri, prof. A.Pezzini dhe Prof. P.Mandarino dhe te tjerëpedagogë e profesorë të këtij universiteti që janë po aq të përgatitur dhe që kanë një bagazh të madh profesional e kulturor...dhe qëpo aq të madh kanë vullnetin dhe disponibilitetin e tyre për të nxjerrë kuadro të devotshëm.